



**Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria-Vlada-Government*

*Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister  
Zyra Ligjore - Zakonodavna Kancelarija - Legal Office*

---

**Raporti për Thjeshtësimin dhe Harmonizimin e Lejeve dhe Licencave në  
Autoritetin e Aviacionit Civil<sup>1</sup>**

---

<sup>1</sup> Kjo analizë juridike është miratuar në Mbledhjen e 254-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 04/254 të datës 26.03.2025.

**AAC** – Autoriteti i Aviacionit Civil

**AESA**- Agjencia Evropiane për Sigurinë Ajrore.

**BE**-Bashkimi Evropian

**GIZ** - Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit

**HPEA**-Hapësira e Përbashkët Evropiane të Aviacionit

**LAC**-Ligji 03/L-051 për Aviacionin Civil

**LPPA** - Ligji Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative

**LSLL**-Ligji Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave

**ONAC**- Organizata Ndërkombëtare të Aviacionit Civil

**PVK** – Pikat e Vetme të Kontaktit

**RQLL**-Registri Qendror i Lejeve dhe Licencave

**ZKM** - Zyra e Kryeministrat

**ZL** - Zyra Ligjore

## **1.Hyrje**

Ky rapport i mbështetur nga projekti i GIZ ka për qëllim që të pasqyrojë të gjeturat dhe rekomandimet e përgjithshme dhe konkrete, për thjeshtimin e procedurave për aplikim, shqyrtim dhe pajisjen me leje dhe licenca në AAC si dhe të bëjë harmonizimin e lejeve dhe licencave të AAC me LSLL. Thjeshtësimi i lejeve dhe licencave, në këtë raport synon të arrihet përmes zbatimit të disa parimeve dhe kërkesave të cilat përcaktohen në LSLL si dhe në LPPA. Në anën tjetër harmonizimi nënkuption përshtatshmërinë e LAC me LSLL në kuptim të lëshimit të lejeve dhe licencave respektive, të cilat lëshohen nga AAC. Gjithnjë në arritjen e qëllimit të këtij reporti do të merren parasysh specifikat e punës së AAC si dhe specifikat e sektorit të aviacionit civil, qoftë në kuptimin e sigurisë e operimeve ajrore apo edhe në kuptimin e direktivave të BE, të cilat kanë një status dhe rëndësi të veçantë të aplikimit obligativ në AAC, e cila do të sqarohet më poshtë.

Në kuadër të këtij reporti është ndjekur metodologji e atillë, ku janë nxjerrë: **1.Rekomandime të përgjithshme dhe 2.Rekomandime të veçanta.** Rekomandimet e veçanta janë të vendosura në shtojcën e këtij reporti dhe janë të dhëna për secilën leje ose licencë, në mënyrë të veçantë, sipas të gjeturave.

Po ashtu, përvèç rekomandimeve në rapport janë pëershruar edhe të gjeturat kryesore si dhe të gjeturat e veçanta, të cilat ndjekin qëllimin e raportit, për thjeshtëzimin e lejeve dhe licencave si dhe harmonizimin e tyre.

Thjeshtëzimi i lejeve dhe licencave dhe harmonizimi i tyre në AAC, sipas këtij rapporti, merr parasysh veçanërisht:

1. Lehtësimi i procedurës së aplikimit për leje dhe licenca;
2. Lehtësimi i barrës administrative të palës me rastin e aplikimit;
3. Lehtësimi i procedurës së shqyrtimit të kërkesës dhe verifikimit të provave/dëshmive;
4. Çështjen e sigurisë së bartësit të licencës, në kuptim të zgjatjes së afatit, bazuar në kriteret e specifikave të licencave ose lejeve, varësisht nga niveli i rrezikshmërisë;
5. Çështja e ligjshmërisë së licencave, dhe bazës specifike ligjore, në kuptimin që të njëjtat të jenë të parapara me ligj, sipas emërtimit nga institucioni që i lëshon, bazuar në regjistrin qendror të lejeve dhe licencave;
6. Çështjen e harmonizimit dhe përshtatshmërisë së kërkesave të LSLL me rregullimet e përcaktuara në LAC dhe aktet nënligjore relevante që aplikohen nga AAC.

Për të hartuar këtë raport janë shqyrtuar disa burime dhe atë si në vijim: LSLL; LPPA; LAC; Ligji për plotësim dhe ndryshim të LAC; Aktet nënligjore që aplikohen nga AAC; RQLL; Takimet dhe të dhënët e marra nga AAC, sipas tabelës. AAC nuk ka dhënë asnjë koment në lidhje me rapportet. Gjithashtu, në këtë aspekt duhet përmendor edhe takimin sqaresh me zyrtarët e AAC, të datës 30.08.2024.

Për efekte të këtij reporti është përdorur terminologjia e emërtimit “leje dhe licenca” sipas LSLL që përfshijnë edhe aplikimin e llojeve të tjera të lejimeve që lëshohen nga AAC dhe nuk emërohen si leje dhe licenca.

## **2.Analiza ligjore përkitazi me thjeshtëzimin e lejeve dhe licencave në AAC**

Në këtë pjesë prezantohet analiza e legjislacionit kryesor që rregullon lejimet (lejet dhe licencat) në AAC. Ligji për sistemin e lejeve dhe licencave (në vijim LSLL) është ligji horizontal që në nenin 1 rregullon parimet dhe rregullat përmirësimin e mjedisit për të bërë biznes, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative, në kryerjen e veprimit tarive ekonomike, tregtarie apo profesionale, që është e domosdoshme për të mbrojtur shëndetin publik, sigurinë publike, mjedisin dhe përdorimin e resurseve natyrore në

Republikën e Kosovës. Ligj tjetër horizontal që rregullon në përgjithësi ushtrimin e autoritetit publik ku më së shpeshti vie në shprehje tek lejimet është Ligji për procedurën e përgjithshme administrative (LPPA), qëllimi i të cilit është të sigurojë realizimin efektiv të autoritetit publik në shërbim të interesit publik, duke garantuar në të njëjtën kohë në nenin 1 edhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave juridike të personave. Megjithatë, në kuptimin e përshtatshmërisë së LAC dhe LSLL duhet të shikohet me kujdes, aspekti i zbatimit LSLL në rastin e AAC, për shkak të aspektit të sigurisë së fluturimeve.

Po ashtu do të analizojmë disa nga parimet dhe rregullat kryesore të parashikuara në këto ligje dhe rregullat si dhe kriteret e veçanta që përcaktohen me LAC dhe aktet e tjera relevante. Realizimi i qëllimit për lehtësimin e lejeve dhe licencave të cilat lëshohen nga AAC, kërkon një analizë të LAC dhe ligjit për plotësimin dhe ndryshimin e LAC. Analiza e LAC dhe LSLL në kuptim të harmonizimit bazohet në gjendjen faktike që nënkuption duke pasur parasysh të gjitha lejet dhe licencat (lejimet), të cilat i lëshon AAC, bazuar në RQLL si dhe në të dhënët e ofruara nga AAC, sipas tabelës dhe të dhënave të tjera që kanë rezultuar nga takimet.

Në kuptim të emërtimit, LSLL në nenin 1 (1.3) përdor termin "**I licencuari – personi fizik të cilit i është lëshuar një licence profesionale**". Në anën tjetër, LAC nuk i referohet specifiksht rasteve se kur lejet dhe licencat që lëshohen nga ana e tyre i dedikohen personave fizik ose atyre juridik (operatorëve të ndryshëm). Në raste të caktuara, sipas definimit të ligjit, siç është për shembull nenit 37 i LAC, nënkuption që licenca i lëshohet personelit të aviacionit. Megjithatë, në kuptim të LSLL, respektivisht nenit 1, siç u theksuar "i licencuari" nënkuption personin fizik, kurse leja nënkuption autoritetin e caktuar (neni 1 par 1.8 i LSLL), që mund të jetë person juridik, që aplikon për tu pajisur me leje.

Këto çështje janë të rregulluara me legjislacionin sekondar të AAC. Sic janë shembujt dhe definicionet e përcaktuara në Rregulloren (AAC) nr. 05/2020 dhe Rregulloren (AAC) nr. 01/2022 'operator i avionit' nënkupton çdo person juridik apo fizik që operon apo propozon të operojë një apo më shumë avionë; 'operator i aerodromit' nënkupton çdo person juridik apo fizik që operon apo propozon të operojë një apo më shumë aerodrome; 'certifikim' nënkuption ndonjë formë të njohjes në përputhje me këtë rregullore, në bazë të vlerësimit të duhur, që një person juridik apo fizik, produkt, pjesë, pajisje jo e instaluar, pajisje për kontrollimin nga distanca të avionit pa pilot, aerodrom, pajisje të aerodromit të ndërlidhura me sigurinë, sistemin e MTA/SHNA, pjesët përbërëse të MTA/SHNA apo mjeti simulues fluturimi për trajnim përmblushë kérkesat e aplikueshme të kësaj rregulloreje dhe të akteve të deleguara dhe zbatuese të miratuarat në bazë të saj, nëpërmjet lëshimit të një certifikate që dëshmon përputhjen e tillë; si dhe po ashtu "Ofruesi i MTA/SHNA" nënkupton çdo person juridik ose fizik që ofron ndonjë nga MTA/SHNA siç përcaktohet në nenin 3 (5) të Rregulloreve 05/2020 të AAC-së, ose individualisht ose me pak o përtakfikun e përgjithshëm ajror. Po ashtu në këtë aspekt ka një mangësi të LSLL.

Përderisa LSLL në nenin 5 ka përcaktuar llojet e lejimeve, siç janë: *njoftimi, regjistrim, leja dhe licenca profesionale*. Në anën tjetër, bazuar në gjendjen faktike dhe licencat që figurojnë në RQLL si dhe të dhënët e pranuara nga AAC, ky autoritet lëshon kategoritë e lejimeve (lejeve dhe licencave) si në vijim: **Aprovimet; Autorizimet; Certifikatat; Certifikimet; Lejet; Licencat; Ndryshimet e Certifikatave; Pranimet; Ripërtërije e certifikatave; Vendimet për miratim**. Megjithatë, siç do të shihet më poshtë, tek rekomandimet e përgjithshme dhe të veçanta, disa lejime (leje dhe licenca) të AAC-së, megjithatë nuk kanë një bazë konkrete ligjore dhe fare nuk përmenden në ligjin për AAC. Nisur nga koncepti i harmonizimit, në përputhje me LSLL, kjo kërkon që të bëhet me ligj. Gjithësi në rastin e AAC, duhet të merren parasysh edhe standardet ndërkombëtare dhe të shuhet mundësia e grupit të licencave, ashtu siç përcakton nenit 5 i LSLL, vetëm duke marrë parasysh nivelin e rrëzikshmërisë.

Në kuadër të sistemit të lejeve dhe licencave të cilat lëshohen nga AAC, bazuar në LAC, çështja e lehtësimit të lejeve dhe licencave në këtë sektor do të analizohet bazuar në disa parime, të cilat njihen nga LSLL dhe LPPA. Këto parime do të shërbejnë për të dhënë rekomandimet e përgjithshme dhe të veçanta, me qëllim të lehtësimit të lejeve dhe licencave që lëshohen nga AAC. Parimet janë si në vijim:

**Afati i kohëzgjatjes së licencës.** LAC nuk përcakton në mënyrë decidive afatin e vlefshmërisë së një leje ose licence që lëshohet nga AAC. Megjithatë, është e rëndësishme që ndërlidhur me parimin e efikasitetit, sipas nenit 10 të LPPA, AAC të ketë parasysh krijimin e rregullave që përcaktojnë afat për se cilën lejim (leje dhe licencë) që lëshon. Kjo kohëzgjatje do të mund të lidhej me nivelin e rrezikut, sigurisë, mbrojtjes së shëndetit publik, llojit të veprimtarisë dhe aspekteve të tjera të rëndësishme që mund të dallojnë varësisht nga leja dhe licenca konkrete. Pra të caktohen kritere të qarta me ligj për çështjen e kohëzgjatjes. Duhet të standardizohet dhe të përcaktohet afati për lejet dhe licencat e AAC. Në kuptim të sqarimeve të dhëna nga AAC, duke pasur parasysh direktivat e BE, është e preferueshme që në rastet ku direktivat përkatëse nuk përcaktojnë afat, licenca të mbetet pa afat, në raste tjera, të vlefshme së afati i direktivës, për licencën përkatëse.

**Parimi i mos diskriminimit.** Ky parim përcaktohet në nenin 6 të LPPA dhe si i tillë duhet të aplikohet edhe nga AAC, në raport me vendosjen për licencat dhe lejimet e tjera që i bën. Veçanërisht ky parim duhet të përcaktohet në mënyrë strikte kur bëhet fjale tek kohëzgjatja e licencës, të cilën AAC e vlerëson dhe e vendos, sipas diskreditonit duke u bazuar në kriteret e kohëzgjatjes minimale dhe maksimale, duke pasur parasysh që në disa raste kohëzgjatja nuk përcaktohet as në akte nënligjore të AAC. Po ashtu, i njëjtë duhet që të bëhet edhe pjesë e procedurave të lëshimit të lejeve dhe licencave në kuadër të AAC, me qëllim të lehtësimit të lejeve dhe licencave.

**E Drejta e ankesës.** Kjo përbën një obligim kushtetues. Sistemi i shqyrtimit të licencave në AAC si dhe procedurat për këtë, nuk parashohin të drejtë e ankesës në rast të refuzimit. Neni 27 paragrafi 2 i LAC i referohet të drejtës së ankesës bazuar në LPPA. LPPA po ashtu në nenin 125 përcakton ankesën si mjet për realizimin e një të drejte të caktuar. Një gjë e tillë përcaktohet po ashtu edhe në nenin 27 të LSLL. Kjo nënkupton që në procedurën administrative të shqyrtimit të lejeve dhe licencave të AAC patjetër duhet të përcaktohet një mekanizëm konkret i ankesës, për të shqyrtau refuzimin eventual të lejes dhe licencës respektive që lëshohet nga AAC. AAC duhet të themelojë një komision të brendshëm të ankesave, i cili adreson refuzimin përkitazi me refuzimin e ankesave. Në këtë aspekt, tek rekomanimet, bazuar edhe në LAC, duhet që të rekomandohet mjeti efektiv juridik, vetëm për procedurën e lejeve dhe licencave në AAC.

**Pagesa e taksave.** LSLL në nenin 18 përcakton një taksë proporcionale, për aq sa ajo është e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin. Në anën tjetër, LPPA përcakton mos pagesën e procedurës dhe sipas kësaj kjo pagesë mund të bëhet vetëm në raste kur përcaktohet ndryshëm me ligj. Ligji për AAC nuk përcakton fare çështjen e pagesës së taksave për lejet dhe licencat që lëshohen nga AAC. Në bazë të LSLL dhe LPPA AAC ka obligim që këto taksa, sidomos ato të aplikimit t'i llogaris në proporcion me shpenzimet administrative. Sipas të dhënavës së AAC, taksat e shqyrtimit të licencës paguhen në momentin e shqyrtimit të aplikacionit. Megjithatë për të lehtësuar çështjen e veprimtarisë së të licencuarve por edhe të licencuarve, AAC aplikon procedurat e pagesës përmes E-Banking. Tarifat që AAC lëshon janë të përcaktuara në mënyrë specifikë në Rregulloren (AAC) nr. 2/2015 për Tarifat e Ngarkuara nga Autoriteti I Aviacionit Civil I Kosovës, me ndryshime.

**Parimi i një sporteli të vetëm (pikat e vetme të kontaktit),** është obligim ligjor i përcaktuar si në LSLL, respektivisht nenin 16 ashtu edhe në LPPA si dhe LPPA nenin 33. Sipas këtij parimi të gjitha formalitet dhe procedurat për lëshimin e një leje dhe licence duhet të kryhen përmes PVK të kontaktit (one stop shop). Të dyja ligjet lejnë hapësirë që PVK të krijohen në mënyrë fizike, elektronike apo të kombinuar. Parakusht kriesor për t'i krijuar PVK janë pikat që i cekëm më lartë, sidomos qasja e orientuar nga parimi i shqyrtimit administrativ sipas detyrës zyrtare. Në AAC nuk ekziston asnjë lloj tipi i PVK prandaj edhe licencat jepen ndaras nga secili organ publik që nënkupton se pala vet i kryen të gjitha formalitetet dhe procedurat që nëse do të ekzistonte PVK mund të kryhesin përmes saj nga vet organi publik.

**Parimi i aplikimit të ndihmës administrative.** Neni 34 i LPPA përcakton: se organi publik mund të kërkojë ndihmë nga një organ tjetër publik, ndër të tjera për njohjen me fakte, dokumente apo mjete të tjera të provës në posedim të organit tjetër. Ky parim mund të përdoret për të lehtësuar procedurën e

verifikimit të dokumenteve të nevojshme. AAC në rastin e shqyrtimit të procedurës së lejeve dhe licencave nuk e aplikon fare parimin e ndihmës juridike. Sipas këtij parimi AAC, duhet të verifikojë një numër të dokumenteve, sipas parimit të ndihmës, në bashkëpunim me organet e tjera kompetente për ndihmuar palës që t'i zvogëlohet barra administrative.

***Shqyrtimi i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare.*** Këtë parim e lejon nen 86 i LPPA. Në fakt ky parim në dritën e lehtësimit të procedurave për dhënин e licencave në AAC, bazuar mënyrën se si rregullohet procedura e licencimit në AAC duhet të kombinohet me parimin e aplikimit të ndihmës administrative. AAC nuk aplikon fare parimin e zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare. Po ashtu, në linjë me këtë AAC nuk ka një rregullore konkrete që trajton procedurën e dhënies së lejeve dhe licencave të cilat figurojnë në RQLL si dhe të cilat i lëshon AAC në bazë të dhënave të ofruara. Neni 86.3 i LPPA, në lidhje me këtë parim përcakton: “*Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, dokumentet që vërtetojnë akte, fakte, cilësi apo gjendje subjektive, të nevojshme për shqyrtimin administrativ, administrohen, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që zhvillon procedurën administrative, nëse janë në administrim të tij apo të organeve të tjera publike. Organi publik mund t'i kërkojë palës vetëm informatat e nevojshme për identifikimin e tyre*”. Kjo nënkupton që në disa raste, kur dokumentet dhe kushtet e dokumentacionit përfundimtare. Në rastin e AAC nuk ka një rregullore që përcakton procedurën dhe që i jep një mundësi palës që përgjatë shqyrtimet të aplikimit për leje dhe licencë, pala të ketë të drejtë të ofrojë deri në momentin e vendosjes përkushtuar e tij/saj prova dhe shpjegime shtesë.

***E Drejta për të ofruar mendime, shpjegime dhe prova:*** Neni 94 i LPPA i lejon palës që përgjatë shqyrtimit dhe zhvillimit të procedurës të ofrojë prova dhe të sqarojë çështjet deri në vendosjen përfundimtare. Në rastin e AAC nuk ka një rregullore që përcakton procedurën dhe që i jep një mundësi palës që përgjatë shqyrtimet të aplikimit për leje dhe licencë, pala të ketë të drejtë të ofrojë deri në momentin e vendosjes përkushtuar e tij/saj prova dhe shpjegime shtesë.

***Zhvillimi i procedurës së shqyrtimit në mënyrë elektronike.*** Neni 14.2. i LSLL përcakton: “*Çdo autoritet kompetent duhet ta bëjë të mundur për një person që aplikacionin për lejim ta bëjë në mënyrë elektronike*”. Një gjë e tillë krijon mundësinë që bazë të akteve të brendshme që nxjerr AAC përfundimtare. Në rastin e AAC nuk ka një rregullore që përcakton procedurën dhe që i jep një mundësi palës që përgjatë shqyrtimet të aplikimit për leje dhe licencë, pala të ketë të drejtë të ofrojë deri në momentin e vendosjes përkushtuar e tij/saj prova dhe shpjegime shtesë.

***Kushtet dhe kriteret specifike për dhënien e licencave.*** Në rastin e AAC, dokumentet e nevojshme përfundimtare, janë mjaft specifike sepse ndërlidhen edhe me: mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë publike; Sigurinë dhe mbi të gjitha kushtëzohen me rregullat ndërkombëtare të aviacionit civil. Duke marrë parasysh specifikat e licencave të AAC, atëherë në disa raste edhe dokumentacioni eshtë specifik. Andaj, në bazë të analizës, reduktimi i dokumentacionit eshtë kerkuar rast pas rasti, bazuar në dy alternativa: 1.Verifikimi i disa fakteve përmes deklaratës nën betim dhe 2. Identifikimi nga pala e disa dokumenteve si dhe veprimi i AAC, sipas parimit të ndihmës administrative dhe zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare.

***Dorëzimi i dokumentacionit në original-***Në kuadër të lejimeve që miraton AAC, ka një fenomen bazuar në Registrin Qendror të Lejeve dhe Licencave (RQLL) dhe ky fenomen ka të bëjë me dorëzimin e disa dokumenteve në original, përfshirë edhe ato dokumente që përbejnë fakte notore dhe madje të pakontestueshme, siç eshtë certifikata e regjistrimit të biznesit ose dëshmitë tjera për themelimin e shoqatës ose konzerciomit (varësisht nga lloji i lejimit) ose statusi i saj, etj. Andaj, ngritja e këtij parimi eshtë bërë me qëllim që një gjë e tillë të konkretizohet tek rekomandimet e veçanta, të përcaktuara në

shtojcën e kësaj analize. Sipas sqarimeve të dhëna nga AAC në shumicën e rasteve kërkohen kopje të dokumentacionit, vetëm në raste specifice mund të kërkohen origjinalet, si psh. Aprovimi i Procedurave përkatëse të nënshkruara nga persona të autorizuar.

### **3. Analiza ligjore përkitazi me harmonizimin**

Përkitazi me ketë raport, harmonizimi nënkupton një proces të përshtatshmërisë së LSLL në rastin konkret dhe LAC, me qëllim të përcaktimit të lejeve dhe licencave që lëshon AAC, bazuar LSLL. Ajo çfarë është me rëndësi të theksohet në lidhje me AAC është fakti se sipas LAC, në Republikën e Kosovës, zbatohen drejtpërdrejtë Konventat Ndërkombëtare të Avacionit Civil si dhe elementet e aquis të BE-së, në bazë të të cilëve edhe lëshohen lejet dhe licencat e AAC. Lidhur me këtë, nenet 3.1 dhe 3.2 i LAC përcaktojnë “*3.1 Aktivitetet e avacionit civil në hapësirën ajrore të Kosovës zhvillohen në pajtim me dispozitat e këtij ligji, Konventën mbi Avacionin Civil Ndërkombëtar të datës 7 Dhjetor 1944 dhe Marrëveshjen për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Avacionit. 3.3 Të gjitha elementet e acquis të BE-së të përmendura ose të përfshira në Shtojcën I ose II të Marrëveshjes për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Avacionit janë drejtpërdrejtë zbatueshme në Kosovë dhe e zëvendësojnë çdo ligj të Kosovës i cili nuk është në përputhje me to*”.

Siq mund të shihet, këto dy nene, në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatojnë rregullat e të drejtës ndërkombëtare, përfshirë konventat, marrëveshje ndërkombëtare dhe të drejtët e BE-së. Megjithatë, nga takimet me AAC është konfirmuar se shumica e lejeve dhe licencave që lëshohen nga kjo agjenci bazën kryesore e kanë në të drejtët ndërkombëtare dhe rregullat e BE-së dhe si tilla kanë lindur si nevojë që të aplikohen, sipas të drejtës së BE-së. Kjo duket të jetë njëra ndër arsyet kryesore, se përsë një numër i madh i lejimeve (lejeve dhe licencave) që i lëshon AAC, nuk kanë bazë konkrete në LAC ose ndonjë ligj tjeter të aplikueshmë që është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Në takimin e datës 30.08.2024, nga AAC është konfirmuar se transpozimi dhe zbatimi i direktivave të BE-së, bëhet duke respektuar procedurat e përcaktuara.

Lidhur me aspektin e harmonizimit mund të përmendim disa parime si në vijim:

**Përcaktimi i lejeve dhe licencave me ligj.** Ky parim përcaktohet në nenin 17.1 të LSLL dhe si i tillë nënkupton që leja dhe licenca, qoftë edhe në kuptimin e emërtimit të përcaktohet me ligj. Në rastin e AAC vetëm disa leje dhe licenca përcaktohen me ligj. Në bazë të LAC, respektivisht neni 32 Certifikata e operatorit ajror njihet si një licencë (lejim) që lëshohet nga AAC për të gjithë shtetasit të cilët dëshirojnë të angazhohen në veprimtari (operacione) ajrore në Kosovë. Po ashtu neni 34 i LAC përcakton licencën për ushtrimin e veprimitarisë së transportit ajror, për të cilën mund të aplikojnë shtetasit e Republikës së Kosovës (personat fizik). Neni 35 i LAC njeh si leje/licencë Certifikatën/Licencën e operatorit ajror për ushtrimin e veprimitarisë ajrore. Neni 36 i LAC njeh licencat dhe lejet për ofrimin e veprimitarisë pa orar. Neni 37 i LAC njeh si lejime licencat e personelit të avacionit, respektivisht personelit që duhet të ketë kualifikimin përkatës. Neni 44 i LAC, njeh si lejime (leje dhe licenca) që i lëshon AAC edhe certifikatën e përshtatshmërisë në fluturim dhe certifikatën e lëshimit në shërbim, të cilat lëshohen për avionët e regjistruar në Kosovë. Neni 46 i LAC, njeh certifikatat e kufizuara të llojit të avionit të cilat lëshohen në rastet e veçanta, sikurse edhe në nenin 47 të LAC, që janë rregulluara rastet e veçanta, respektivisht lëshimi i certifikatave të kufizuara të përshtatshmërisë në fluturim, që i dedikohen avionëve të regjistruar në Kosovë. Neni 57 i LAC, ka rregulluar kategorinë e lejeve të cilat lëshohen për Armët dhe municionin, duke përshirë eksplozivet dhe gazrat e dëmshme ose helmuese, duhet të transportohen në bord të avionit. Këto leje lëshohen nën tri kushte kryesore si në vijim: 1.vetëm me lejen me shkrim të AAC-së, (2.në mbikëqyrjen e pilotit komandues, dhe 3.në përputhje të plotë me rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare. Po ashtu, neni 61 i LAC, njeh edhe certifikatën e aerodromit, si lejim (leje apo licencë) që lëshohet nga AAC, e cila lëshohet për persona që marrin përsipër drejtimin (operimin) e një aerodromi. Në këtë aspekt, një karakteristikë e lejeve dhe licencave në AAC është, që një pjesë e madhe e tyre

përcaktohen vetëm me akte nënligjore të AAC, në kundërshtim me nenin 17.1 të LSLL. Megjithatë aktet nënligjore dhe përcaktimi i licencave me këto akte, janë analizuar në shtojcën e këtij raporti.

Në bazë të neneve 32,34,35,36,37,44,46,47,57 dhe 61 të LAC, njihen lejet dhe licencat (lejimet) si në vijim

1. Certifikata e operatorit ajror njihet si një licencë (lejim) që lëshohet nga AAC për të gjithë shtetasit të cilët dëshirojnë të angazhohen në veprimtarisë (operacione) ajrore në Kosovë.
2. Licença për ushtrimin e veprimitarës së transportit ajror, për të cilën mund të aplikojnë shtetasit e Republikës së Kosovës (personat fizik).
3. Certifikatën/Licencën e operatorit ajror për ushtrimin e veprimitarës ajrore.
4. Licencat dhe lejet për ofrimin e veprimitarës pa orar.
5. Licencat e personelit të aviacionit, respektivisht personelit që duhet të ketë kualifikimin përkatës.
6. Lejime (leje dhe licenca) që i lëshon AAC edhe certifikatën e përshtatshmërisë në fluturim dhe certifikatën e lëshimit në shërbim, të cilat lëshohen për avionët e regjistruar në Kosovë.
7. Certifikatat e kufizuara të llojit të avionit të cilat lëshohen në rastet e veçanta, sikurse edhe në certifikatat që janë rregulluara rastet e veçanta, respektivisht lëshimi i certifikatave të kufizuara të përshtatshmërisë në fluturim, që i dedikohen avionëve të regjistruar në Kosovë.
8. Lejet të cilat lëshohen nga AAC për Armet dhe municionin, duke përshirë eksplozivet dhe gazrat e dëmshme ose helmuese që duhet të transportohen në bord të avionit.
9. Certifikatën e aerodromit, si lejim (leje apo licence) që lëshohet nga AAC, e cila lëshohet për persona që marrin përsipër drejtimin (operimin) e një aerodromi.

Nga regjistri i 79 lejeve dhe licencave që lëshon AAC, LAC njeh vetëm kategoritë e mësipërme të lejeve dhe licencave të mësipërme dhe që lëshohen për veprimitaritë e mësipërme. Të gjitha lejet dhe licencat që nuk hyjnë në llojin e mësipërm të lejeve dhe licencave ose në veprimitarë e mësipërme që njeh LAC, nënkupton që nuk njihen me ligj, siç e përcakton neni 17 i LSLL. Këto do të përcaktohen tek rekomandimet e veçanta.

**Emërtimet e lejeve dhe licencave të përcaktohen me ligj:** Kjo kërkon që të gjitha lejet dhe licencat që lëshon AAC, si: Aprovimet; Autorizimet; Certifikatat; Certifikimet; Lejet; Licencat; Ndryshimet e Certifikatave; Pranimet; Ripërtërije e certifikatave; Vendimet për miratim të përcaktohen me ligj. Një numër i caktuar i kategorive të lejeve dhe licencave që lëshohen nga AAC, siç janë aprovimet dhe autorizimet, si kategori nuk njohën fare me LAC dhe nuk kanë bazë ligjore konkrete. Po ashtu, në kuadër të rekomandimeve të veçanta, për secilën leje dhe licencë janë dhënë rekomandime të veçanta, në kuptimin nëse lloji i lejes dhe licencës është i përcaktuar me ligj, ose veprimitaria për të cilën është lëshuar ajo, hyn në kategorinë e veprimitarive të përcaktuara në llojet e lejeve dhe licencave të elaboruara me sipër, sipas neneve 32,34,35,36,37,44,46,47,57 dhe 61 të LAC.

**Përshtatshmëria e lejeve dhe licencave sipas nenit 5 të LSLL:** Neni 5 i LSLL përcakton llojet e lejimeve të cilat janë: njoftim, regjistrim, leje dhe licenca profesionale. Në këtë rast edhe emërtimet e lejimeve që i bën AAC duhet ti përshtaten këtij. Kjo nënkupton që nenet e LAC siç janë: nenet, 32,33,34,35,36,37,38,44,46,47,57 që përcaktojnë llojet e caktuara të lejeve dhe licencave do të ndryshohen. Në këtë aspekt, është e rendësishme që të bëhet emërtimi dhe kategorizimi i lejeve dhe licencave të AAC, bazuar në nenin 5 të LSLL.

**Kategorizimi i lejeve dhe licencave sipas rrrezikut:** LAC duhet të përcaktojë një sistem të kategorizimit të lejeve dhe licencave, sipas rrrezikut, sikurse e përcakton edhe neni 19 i LSLL. Për këtë duhet të plotësohet ose duhet të krijohet një nen i ri në LAC, pas nenit 31. AAC përmes Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë përcakton nivelin e rrrezikut në të gjitha fushat që i rregullon. Për më tepër AAC përcakton futjen e legjislacionit të ri në agjendë, bazuar në rekomandimet dhe Marrëveshjet ndërkombëtare që zbaton.

**Të përcaktohet si kompetencë e bordit lëshimi i lejeve dhe licencave:** Ligji Nr. 03/L-051 për Avacionin Civil dhe Ligji Nr. 08/L-063 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me racionalismin dhe vendosjen e vijave Llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura nuk përcakton që cili organ është kompetent për lëshimin e lejeve dhe licencave. Neni 15.1 pika "d" e Ligjit Nr. 08/L-063 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me racionalismin dhe vendosjen e vijave Llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura përcakton që AAC bën lëshimin e licencave, certifikatave dhe lejeve. Në anën tjetër neni 10 i LSLL përcakton si në vijim: "1. Autoriteti kompetent, për çdo lloj të licencimit profesional që ndërmerr, krijon bord licencimi. 2. Bordi i licencimit vepron si organ ekzekutiv që administron dhe mbikëqyrë të gjitha fushat që kanë të bëjnë me licencimin e profesionistëve në atë profesion". Pra, me ndryshimin dhe plotësimin e LAC, duhet të përcaktohet që bordi lëshon vendimet respektive për dhënien e lejeve dhe licencave në AAC. Sipas sqarimit të AAC, në bazë të nenit 21 të LAC, Drejtori i përgjithshëm është i autorizuar për lëshimin e të gjitha lejeve dhe licencave, bazuar në rekondimet profesionale të njësive përkatëse përbrenda AAC-së. Kjo çështje është e rregulluar në mënyrë specifike me legjislacion sekondar dhe me procedura dhe procese të AAC-së.

#### 4.Të gjeturat kryesore

1. Ligji për LSLL të "të licencuarit" i referohet vetëm personit fizik, kurse LAC, nënkuftohet që për leje dhe licenca të caktuara mund të aplikojnë edhe personat juridik. Një gjë e tillë është sqaruar më sipër dhe se në shumicën e rasteve kjo adresohet me aktet nënligjore të AAC.
2. Një numër i konsiderueshëm i lejeve dhe licencave nuk përcaktohen me ligj;
3. Të gjitha licencat e LAC janë me afat të caktuar, sipas rregullave të brendshme (në disa raste afati nuk përcaktohet me rregulla të brendshme, sipas nenit 17 të LSLL), ndërsa LSLL, nuk rregullon çështjen e ri licencimit ose vazhdimit të licencës.
4. Nuk përcaktohet një procedurë konkrete e ankesës për mos licencim, përmes një mekanizmi që trajton vetëm çështjet e licencimit, por kjo bëhet përmes një komisioni të përgjithshëm për ankesa.
5. Nuk ka një pikë të vetme të kontaktit (PVK) në AAC, përkitazi me aplikimin për licenca dhe lejime të tjera.
6. Nuk zbatohet parimi i ndihmës administrative për të lehtësuar procedurën e verifikimit të dokumenteve të nevojshme që dorëzohen për licencë, për aq sa është e mundur në AAC.
7. Nuk zbatohet parimi i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, për verifikimin e dokumenteve të identifikuara nga palët, që i posedojnë institucionet publike për aq sa është e mundur.
8. Nuk përcaktohet procedura elektronike si rregull por vetëm si përjashtim.
9. Një numër i dokumenteve që kërkohen tek kategoria e kërkesave të përgjithshme, duken që shtojnë barrën administrative për mënyrën se si kërkohen.
10. Nuk ekziston një procedurë uniforme administrative e aplikimit, shqyrtimit, miratimit ose refuzimit të lejes dhe licencës që lëshohet nga AAC.
11. Në disa raste disa rregullore, sidomos ato para vitit 2017, duhet të publikohen edhe në gjuhën shqipe.
12. Në disa raste, tarifa e përcaktuar për një licencë, sipas të dhënave të ofruara nga AAC, nuk përcaktohet me rregullore.
13. Në disa raste, tarifa duket se nuk ndjek një qasje proporcionale me shpenzimet e nevojshme administrative për dhënien e licencës, ashtu siç kërkohet me LSLL.
14. Afati i licencës nuk është i përcaktuar me akte nënligjore;
15. Nuk ka harmonizimin të lejeve dhe licencave, bazuar në nenin 5 të LSLL;
16. Mungojnë programe të arsimimit të vazhdueshëm, sipas kërkesave të LSLL.

## **5.Rekomandimet e përgjithshme**

1. Të rregullohet më specifisht, se kush mund të aplikojë për licencë dhe për cilat licenca (person fizik ose juridik), në të gjitha rastet.
2. Të krijohet bazë e qartë ligjore për licencat ekzistuese të AAC.
3. Të zgjatet afati i dhënies së licencës nga AAC, respektivisht duke pasur parasysh parimin e efikasitetit të procedurës dhe niveli të rezikut të lejes po licencës.
4. Të bëhet harmonizimi i ligjit për AAC, respektivisht plotësimi i neneve 32,33,34,35,36,37,38,44,46,47,57 të LAC, në kuptimin e emërtimit të lejimeve nga AAC, për veprimtaritë që nuk kërkojnë licencë, bazuar në nenin 5 të LSLL.
5. Të përcaktohet procedura e ankesës për rast të mos licencimit, përmes një mekanizmi që trajton vetëm aspektin e licencave.
6. Të krijohet një PVK në AAC.
7. Të zhvillohet procedurë elektronike për aplikim dhe shqyrtim të licencave dhe të mos jetë domosdoshmëri vetëm aplikimi në kopje fizike.
8. Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike, për aq sa është e mundur.
9. Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio, për aq sa është e mundur.
10. Të verifikohen disa dokumente të nevojshme sipas deklaratës nën betim.
11. Pagesa e taksave fillestare të shqyrtimit të bëhet pas aprovimit të kërkesës.
12. Të përcaktohet me rregullore përkatëse Arsimimi i vazhdueshëm, sipas nenit 13 të LSLL.
13. Tarifat në secilin rast të caktohet me akte nënligjore.
14. Lartësia e tarifave të jetë proporcionale me shpenzimet e nevojshme administrative gjatë procedurës së dhënies së licencës.
15. Kohëzgjatja e licencave të përcaktohet me akte nënligjore dhe pa afat.
16. Veprimtaria e licencave të përcaktohet me akte nënligjore.
17. Të aplikohet afati 45 ditor i vendosjes për kërkesat për leje dhe licenca, sipas LPPA, përvçe rasteve kur kjo përcaktohet në direktiva, për shkak të obligimeve që dalin nga MSA.

## **6.Arsyetimi i rekomandimeve të përgjithshme**

**1.Të rregullohet më specifisht, se kush mund të aplikojë për licencë dhe për cilat licenca (person fizik ose juridik).** Ky rekomandim është dhënë për arsyet se në Ligjin për AAC nuk përcaktohet statusi të licencuarit, pra në kuptimin se a do të jetë person fizik ose juridik. Në anën tjetër, LSLL përcakton saktë në definicione, se për cilat leje dhe licenca aplikojnë personat fizik apo juridik. Në disa raste aktet nënligjore e përcaktojnë një gjë të tillë në AAC dhe kjo duhet të vlejë për të gjitha rastet.

**2.Të krijohet bazë e qartë ligjore për licencat ekzistuese të AAC.** Bazuar në nenin 17.2 të LSLL lejet dhe licencat përcaktohen vetëm me ligj. Në rastin konkret në disa raste AAC nuk i ka të përcaktuara me ligj 79 lejet dhe licencat që i lëshon, e as veprimtaria e tyre nuk është e përcaktuar me ligj. Si rezultat i kësaj, në LAC duhet të krijohen nene të reja që mundësojnë që lejet dhe licencat ekzistuese të përcaktohen me ligj.

**3.Të zgjatet afati i dhënies së licencës nga AAC, duke pasur parasysh parimin e efikasitetit të procedurës dhe niveli të rezikut të lejes po licencës ose licencat të jenë pa afat.** Duke pasur parasysh parimin e efikasitetit, për aq sa është e mundur duhet që të zgjatet afati i lejeve dhe licencave që jepen për afat të shkurtër. Kjo duhet të bëhet duke pasur parasysh sigurinë, mbrojtjen e shëndetit publik dhe kriteret

e tjera që i përcakton AAC. Afati minimal për secilën licencë të jetë 5 vite. Ky rekomandim të aplikohet për aq sa është e mundur, bazuar edhe në direktivat e aplikueshme dhe në rastet kur direktiva nuk, licenca të lëshohet pa afat dhe pastaj të mbikëqyret përmes mekanizmave monitorues.

**4.Rastet kur nuk kërkohet licence të emërtohen sipas LSLL.** Në nenin 5 të LSLL përcakton llojet e lejimeve. Në anën tjetër Ligji për AAC përcakton kriteret për lejimet që nuk kërkojnë licencë, por megjithatë kalojnë në procedurë të miratimit. Andaj, një gjë e tillë duhet të bëhet sipas emërtimeve që i ka përcaktua nenin 5 i LSLL, si njoftim, regjistrim leje etj. Kjo nënkuption se duhet të bëhet harmonizimi i ligjit për AAC, respektivisht plotësimi i neneve 32,33,34,35,36,37,38,44,46,47,57 të LAC, në kuptimin e emërtimit të lejimeve nga AAC, për veprimtaritë që nuk kërkojnë licencë, bazuar në nenin 5 të LSLL. Po ashtu, sipas sqarimeve të AAC, rekomandohet edhe të bëhet kategorizimi i lejeve dhe licencave që lëshohen nga AAC, bazuar në nenin 5 të LSLL.

**5.Të përcaktohet procedura e ankesës pér rast të mos licencimit.** Në kuadër të ligjit, por as rregullat përkatëse, që vleinë pér procedurën e dhënes së lejimeve në kuadër të AAC, nuk kanë përcaktuar një afat ankesë pér çështjen e refuzimit të licencimit ose vazhdimit të licencës. Pér të respektuar të drejtat e palës duhet të krijuhet një mekanizëm i ankesës, sipas parimeve të përcaktuara në LPPA. Një opsion tjetër i procedurës së ankesës mund të mbetet që me rastin e lëshimit të licencës nga drejtori, mjeti juridik i menjëhershëm të jetë Gjykata Kompetente.

**6.Të krijuhet një PVK në AAC.** Një sportel i vetëm apo pikë e vetme e kontaktit duhet të krijuhet në AAC, përsa i takon procedurës së aplikimit dhe shqyrtimit të licencave dhe lejimeve tjera AAC. Kjo pikë e vetme e kontaktit do të lehtësojë procedurën dhe do të koncentrojë kapacitetet shqyrta e në këtë pikë. Po ashtu një gjë e tillë do të ndihmojë aplikuesit që në mënyrë efikase të fillojnë dhe përfundojnë procedurën si dhe gjithashtu, kjo do ti ndihmoj edhe organin që më lehtësish të shqyrtoj aplikimin. PVK duhet të veprojë edhe me rastin e ndryshimit të licencës apo lejimit si dhe procedurat e tjera të ankesës në procedurë të shqyrtimit etj.

**7.Të zhvillohet procedurë elektronike pér aplikim dhe shqyrtim të licencave dhe të mos jetë domosdoshmëri vetëm aplikimi në kopje fizike.** Procedura elektronike e shqyrtimit të lejeve dhe licencave lehtëson jashtëzakonisht shumë aplikimin dhe shqyrtimin e licencave dhe lejimeve në AAC. Me krijimin e pikave të vetme të kontaktit mund të krijuhet edhe një databaza, ose formë e aplikimit elektronik. AAC duhet të aplikojë mundësinë që vetëm dokumentet që duhet domosdoshmërisht pér verifikim të dërgohen nga pala si dokumente fizike ose origjinale. Procedura elektronike mund të caktohet me rregulla të brendshme të AAC. Sipas sqarimeve të AAC, aplikacionet pranohen dhe në mënyrë elektronike.

**8.Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike.** AAC duhet të aplikojë parimin e ndihmës administrative, përgjatë zhvillimit të procedurës dhe këtë ta bëjë të kombinuar me parimin e zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare. Përmes aplikimit të këtij parimi, AAC do të verifikojmë një numër të dëshmive, të cilat nevojiten që të dorëzohen nga pala me parashtimin e kërkesës. Përmes aplikimit të këtyre parimeve, AAC do të shmang dorëzimin e disa dokumenteve pér leje dhe licenca pér palët. Një pjesë e dokumentacionit duhet të verifikohet duke kërkuar ndihmë nga organet e ndryshme administrative.

**9.Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio.** Me rastin e ripërtërirës së licencës, procedura e verifikimit të fillohet dhe të përfundohet duke respektuar veprimin e ndërmarrjes së procedurave sipas detyrës zyrtare. Ky parim do të vinte në shprehje edhe me rastin e ripërtërirës së licencës si dhe modifikimit të saj. AAC ka obligim që kur dokumentet e nevojshme vërtetohen nga organet përkatëse

kompetente, vërtetimi të bëhet duke u bazuar në veprimin sipas detyrës zyrtare, pa e ngarkuar palën me dokumentacion dhe informacion që mund të merret nga organet.

**10.Të verifikohen disa dokumente të nevojshme sipas deklaratës nën betim.** Disa dokumente të nevojshme me rastin e aplikimit për licenca dhe lejime në AAC rekomandohet të reduktohen, për të lehtësuar barrën administrative. Reduktimi i këtyre dokumenteve mund të bëhet në atë mënyrë që disa çështje që duhet të jenë pjesë e aplikacionit, të vërtetohen përmes deklaratës nën betim.

**11.Pagesa e taksave fillestare të shqyrimit të bëhet pas aprovimit të kërkesës.** Duke pasur parasysh pagesën e taksave dhe faktin që këto taksave janë të llogaritura në bazë të parimit e llogaritjes në pajtim me shpenzimet specifike administrative të arsyeshme të shkaktuara në trajtimin e akteve të cilat u referohen taksat e tillë. Për të lehtësuar barrën administrative, taksa fillestare duhet të paguhet në mënyrë elektronike si dhe pasi që të miratohet kërkesa e aplikuesit.

**12.Të përcaktohet me rregullore përkatëse Arsimit i vazhdueshëm.** Sipas nenit 13 të LSLL. Me qëllim të harmonizimit të LAC dhe LSLL, duhet që me rregullore të veçantë, duhet të rregullohet çështja e arsimit të vazhdueshëm, si obligim për të licencuarit dhe kjo duhet të vendoset edhe si kusht në lejet dhe licencat përkatëse.

**13.Të nxjerrët një rregullore përkatëse që rregullon procedurat e aplikimit dhe shqyrimit të lejeve dhe licencave, sipas parimeve të LPPA dhe LSLL.** Me qëllim të rregullimit të procedurës së unifikuar që garanton zbatimin e parimeve të LPPA dhe LSLL, duhet të nxjerrët një rregullore që ka për objekt trajtimin e procedurës së aplikimit dhe shqyrimit për leje dhe licenca në kuadër të AAC, bazuar në parimet e LPPA dhe dispozitat e LSLL.

**14.Tarifat në secilin rast të caktohen me akte nënligjore.** Në rregullohet e AAC lidhur me disa tarifat, nuk përcaktohet tarifa lidhur me disa licenca. Referencia për tarifa në këto raste është marrë nga të dhënat e ofruara nga AAC. Me qëllim të rritjet se sigurisë juridike, me akte nënligjore të AAC duhet të përcaktohet lartësia e tarifës për secilën licencë.

**15.Lartësia e tarifave të jetë proporcionale me shpenzimet e nevojshme administrative gjatë procedurës së dhënies së licencës.** LSLL në nenin 18 përcakton një taksë proporcionale, për aq sa ajo është e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin. Në përputhje me këtë parim duhet të jetë edhe niveli i taksës. Për më tepër, është e nevojshme që tarifa të jetë fiksë dhe mos të përcaktohet përmes elementeve dytësore që mundësojnë caktimin e tarifës. Një qasje e tillë ka potencial të paraqesë diskriminim apo pasiguri juridike. Për këtë arsy, AAC duhet të përcaktojë tarifa fikse.

**16.Afati i licencës të përcaktohet me rregullore ose licencat të lëshohen pa afat.** Në disa raste, afati i licencës është marrë nga të dhënat e ofruara nga AAC dhe në të njëjtat raste, në rregullativën e AAC, nuk është gjetur ndonjë dispozitë që flet lidhur me kohëzgjatjen e këtyre licencave. Në përputhje me nenin 17 të LSLL dhe me qëllim të rritjes së sigurisë juridike, duhet të miratohen rregulla që përcaktojnë kohëzgjatjen e kësaj licence. Në asnjë rast afati nuk është i përcaktuar me ndonjë akt juridik, andaj duhet të merret parasysh që kohëzgjatja e licencave duhet të përcaktohet me ligj ose akt nënligjor dhe se minimumi i kohëzgjatjes të jetë 5 vite. Po ashtu, në rastet kur afati i licencës nuk përcaktohet me direktivë, të njëjtat (licencat) të lëshohen pa afat.

**17.Veprimtaria e licencave të përcaktohet me akte nënligjore.** Përgjatë hulumtimit lidhur me këtë raport, në disa raste veprimtaria e licencave përkatëse nuk është i përshkruar saktësisht. Andaj, bazuar në

ninen 17.2 të LSLL, rekomandohet që me rastin e nxjerrjes së rregulloreve të veçanta procedurale, për secilën leje dhe licencë të përcaktohet më saktësish vepamtaria e tyre.

**18. Të aplikohet afati 45 ditor i vendosjes për kërkesat për leje dhe licenca, sipas LPPA -AAC** në shumicën e rasteve të vendosjes aplikon afatin e për vendosje lidhur me kërkesën për leje dhe licencë në kohëzgjatje prej 90 ditësh. Me qëllim të lehtësimit të procedurës dhe barrës administrative, AAC duhet të aplikojë afatin e vendosjes për kërkesën për leje dhe licencë, prej 45 ditësh, në pajtim me kërkesat e LPPA. Aplikimi i afatit 45 ditor do të zvogëlonë kohëzgjatjen e vendosjes dhe do të rriste efikasitetin si dhe lehtësonë barrën administrative të palës. Ky parim duhet të aplikohet për aq sa është e mundur, duke respektuar direktivat e transponuara sipas procedurave dhe sipas obligimeve në MSA.

## **7.Zbatimi i rekomandimeve të përgjithshme dhe të veçanta**

Në kuadër të raportit, siç u theksua janë dhënë rekomandimet e përgjithshme dhe ato të veçanta, të paraqitura në shtojcë për secilën licencë. Duhet konstatuar, se për shkak të faktit se LAC njeh disa kategori të lejimeve, sipas sqarimeve të mësipërme, rekomandimet e veçanta në shtojcë, për leje dhe licenca të AAC në disa raste kanë rezultuar të jenë të njëjtë. Një gjë e tillë ka ardhur në shprehje për faktin se një numër i caktuar të lejeve dhe licencave, me emërtim të njëjtë (homogen) lëshohen më bazë të njëjtë ligjore. Po ashtu, rekomandimet e veçanta në shumicën e rasteve kanë ardhur si pasojë që shumica e lejeve dhe licencave në AAC, nuk përcaktohen specifisht me ligj.

Zbatimi i rekomandimeve të përgjithshme dhe të veçanta, sipas shtojcës mund të bëhet në dy mënyrë dhe atë: 1.Përmes të plotësimeve dhe ndryshimeve të LAC dhe 2.Përmes plotësimeve dhe ndryshimeve të rregulloreve të brendshme të AAC si dhe hartimin e rregulloreve të reja.

Rekomandimet e përgjithëshme dhe të veçanta janë dhënë, në bazë të analizës së dokumenteve, rregulloreve, të dhënavë të AAC dhe sqarimeve të marra në takime nga ana e AAC.

## **SHTOJCA**

**Në shtojcë janë përfshirë lejet dhe licencat e lëshuara nga AAC**

## 1. APROVIMI I AERODROMEVE – KLASA A

### 1. Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës

Kjo licencë rregullohet vetëm sipas Rregullores Nr 03/2012 mbi aerodromet e aprovuara. Kjo rregullore, ndër të tjera, është nxjerrë në bazë të nenit 61.2. të LAC që përcakton se “*Në rregulloret për zbatimin e këtij ligji, AAC po ashtu do të përcaktojë standartet minimale të sigurisë për operimin e një aerodromi i cili ushtron veprimitari për pasagjerë me apo pa orar të caktuar*”. Kështu, ky lloj licence nuk përcaktohet me LAC. Për më tepër, “aprovimi” si lloj i licencës nuk njihet fare nga LAC.

#### 1.1. Veprimitaria për të cilën lëshohet leja/licenca

Qëllimi i kësaj procedure është licencimi në lidhje me operimin e Aerodromeve, për të cilin operim, AAC duhet të sigurohet se bëhet në përputhje me kërkesat ligjore.

#### 1.2 Vlefshmëria kohore e lejes/licencës

Pesë (5) vite.

#### 1.3 Pagesa për pajisjen me leje/licencë

Sipas Rregullores nr. 2/2015 për Tarifat e Ngarkuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës i pagesa për këtë aprovim është 8.000 euro. Me rastin e aplikimit, parashtruesi duhet të paguajë 50% të kësaj tarife, apo 4.000 euro.

#### 1.4.Dokumentet e nevojshme për aplikim

1. Një kopje të Procedurave të Operimeve dhe Mirëmbajtjes së Aerodromit, të përgatitura në pajtim me Rregulloren 3/2012 për Aerodromet e Aprovuara dhe në përputhje me aktivitetet e pritshme në aerodrome;
2. Detajet e karakteristikave fizike të aerodromit, pajisjeve, shërbimeve dhe mjeteve, përfshirë edhe hartat aeronautike (hartën e aerodromit dhe hartën e pengesave);
3. Kopjen origjinale/të vërtetuar të regjistrimit të biznesit;
4. Dëshminë mbi pronësinë e aerodromit apo të drejtës për shfrytëzim;
5. të dhënat (CV) për stafin e lartë drejtues së aerodromit dhe
6. dëshminë e pagesës së 50% të shumës së tarifës, në përputhje me rregulloren në fuqi për tarifat e ngarkuara nga AAC.

## 2. Rekomandimet

1. Kjo licencë të përcaktohet me ligj;
2. Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuadër të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike;
3. Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio;
4. Të rishikohet tarifa për aplikim;
5. Të krijohet një PVK në AAC;
6. Të hartohet një rregullore e veçantë për procedurën dhe kriteret e lëshimit të aprovimeve.

## 3. Arsyetimi i rekomandimeve

- Kjo licencë të përcaktohet me ligj.** LSLL është ligj horizontal, në përputhje me të cilin Ligj duhet të jenë edhe ligjet e tjera. Ky ligj nuk i njeh "aprovimet" si lloje të lejimeve, të përcaktuara në nenin 5 të tij. Për këtë arsy, në LAC dhe aktet përkatëse nënligjore duhet të adresohet kjo çështje dhe emërtimi të jetë në përputhje me LSLL. Po ashtu, neni 17.1 i LSLL përcakton që licencat duhet të përcaktohen vetëm me ligj.
- Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike.** AAC duhet të aplikojë parimin e ndihmës administrative, përgjatë zhvillimit të procedurës dhe këtë ta bëjë të kombinuar me parimin e zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare. Në rastin konkret, kjo mund të aplikohet lidhur "**kopjen origjinale/të vërtetuar të regjistrimit të biznesit dhe "dëshminë mbi pronësinë e aerodromit apo të drejtës për shfrytëzim**". Përmes aplikimit të këtyre parimeve, AAC do të shmang dorëzimin e këtyre dokumenteve dhe do të lehtësojnë barrën administrative për aplikim.
#### 1.1. Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca

Qëllimi i kësaj procedure administrative është thjeshtësimi i përdorshmërisë së bazës ligjore për dhënien e certifikatës së zhurmës për mjetet ajrore.

#### 1.2. Vlefshmëria kohore e lejes/licencës

Pa afat te caktuar.

#### 1.3. Pagesa për pajisjen me leje/licencë

200 euro

#### **1.4. Dokumentet e nevojshme për aplikim**

1. Informata kontaktuese te aplikuesit
2. Informata mbi mjetin ajror [Origjinal]

#### **2. Rekomandimet**

1. Kjo licencë të përcaktohet me ligj;
2. Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike;
3. Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio;
4. Të rishikohet tarifa për aplikim;
5. Të krijohet një PVK në AAC;
6. Të hartoher një rregullore e veçantë për procedurën dhe kriteret e lëshimit të aprovimeve.

#### **3. Arsyetimi i rekomandimeve**

1. **Kjo licencë të përcaktohet me ligj.** LSLL ështëligj horizontal, në përputhje me të cilin Ligj duhet të jenë edhe ligjet e tjera. Në LAC dhe aktet përkatëse nënligjore duhet të adresohet kjo çështje dhe emërtimi të jetë në përputhje me LSLL. Po ashtu, nen 17.1 i LSLL përcakton që licencat duhet të përcaktohen vetëm me ligj.
2. **Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike.** AAC duhet të aplikojë parimin e ndihmës administrative, përgjatë zhvillimit të procedurës dhe këtë ta bëjë të kombinuar me parimin e zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare. Përmes aplikimit të këtyre parimeve, AAC do të shhang dorëzimin e këtyre dokumenteve dhe do të lehtësojnë barrën administrative për aplikim.
3. **Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio.** Me qëllim të lehtësimit të barrës administrative ta aplikuesit, ripërtërija e kësaj licence duhet të bëhet sipas detyrës zyrtare, përmes ndonjë procedurë të verifikimin ex-officio të fakteve dhe jo përmes një procedure të re administrative për aplikim. Kjo mund të përcaktohet me akt nënligjor nga ana e AAC. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton nen 17.2 i LSLL.
4. **Të rishikohet tarifa për aplikim.** LSLL në nenin 18 përcakton një taksë proporcionale, për aq sa ajo është e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin. Në rastin konkret, pagesa prej 1.000 eurove duket se nuk ka ndjekur një qasje proporcionale. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton nen 17.2 i LSLL.
5. **Të krijohet një PVK në AAC.** Një sportel i vetëm apo pikë e vetme e kontaktit duhet të krijohet në AAC, përsa i takon procedurës së aplikimit dhe shqyrtimit të licencave dhe lejimeve tjera të AAC. Kjo pikë e vetme e kontaktit do të lehtësojë procedurën dhe do të koncentrojë kapacitetet shqyrtuese në këtë pikë. Po ashtu një gjë e tillë do të ndihmojë aplikuesit që në mënyrë efikase të fillojnë dhe përfundojnë procedurën si dhe gjithashtu, kjo do t'i ndihmoj edhe organin që më lehtësish të shqyrtoj aplikimin. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton nen 17.2 i LSLL.
6. **Të hartoher një rregullore e veçantë për procedurën dhe kriteret e lëshimit.** Me qëllim të uniforimit të procedurave të aplikimit për këtë licencë, kritereve për këtë licencë, dokumentet e nevojshëm dhe çështjet e tjera të shqyrtimit, konform LPPA, rekomandohet të nxjerrët një rregullore e veçantë për procedurën dhe kriteret e lëshimit. Një rregullore e tillë, në të cilën dotë ndihmonte AAC për ti jetësuar parimet e LPPA dhe LSLL, në lehtësimin e procedurave për lëshimin e kësaj leje

dhe licence si dhe do ti ndihmonte palët që në mënyrë efikase të informoheshin për procedurat, kriteret dhe aspektet e tjera për lëshimin në fjalë.

## **62. ÇERTIFIKIM PËR ORGANIZATË TRAJNUSE**

### **1. Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës.**

Kjo licencë nuk përcaktohet me ligj. Dispozitat që kanë të bëjnë me këtë licencë janë pjesë e Rregullores Nr. 19/2017 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror.

#### **1.1 Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca**

Qëllimi i kësaj procedure është siguria se një organizatë trajnuese, ofron një shërbim të sigurt, cilësor dhe efikas në bazë të rregullave dhe standardeve më të larta për siguri në avionin civil, sipas ligjit për avionin civil (Ref. Konventa e ICAO-s dhe aktet juridike të BE-së (sipas RQLL).

#### **1.2 Vlefshmëria kohore e lejes/licencës**

Dy (2) deri gjashte (6) vite.

#### **1.3 Pagesa për pajisjen me leje/licencë**

2,000.00 € për lëshimi i certifikatës,  
1,000.00 € për ripërtëritjen e certifikatës,  
500.00 € për amendamentimin e certifikatës.

#### **1.4 Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

1. Emri, mbiemri dhe adresa e aplikuesit
2. Adresa e ndërmarrjes
3. Numri i telefonit, numri i faksit dhe e-mail adresa e personit përgjegjës
4. Përshkrimi i shërbimeve për të cilat aplikohet
5. Një deklaratë të nënshkruar nga Kryeshefi Ekzekutiv apo ekuivalent që konfirmon se organizata dhe çdo dokumentacion referues i cekur definon përputhshmërinë aktuale dhe në vazhdimësi, të organizatës me të gjitha Kërkesat e apilkueshme dhe pajtohet që t'i ofroj AAC-së çdo informatë për vlerësimin e përshkrimit [Origjinal]
6. Politika e organizatës për siguri në pajtim me direktivat e Kërkesave të Përbashkëta [Origjinal]
7. Titujt e pozitive dhe emrat e menaxhmentit të lartë [Origjinal]
8. Një strukturë organizative që tregon linjën e përgjegjësive të menaxhmentit në fushat e mbuluara nga Kërkesat e Përbashkëta [Origjinal]
9. Një strukturë organizative që tregon linjën e përgjegjësive të menaxhmentit në fushat e mbuluara nga Kërkesat e Përbashkëta [Origjinal]
10. Një përshkrim të përgjithshëm të resurseve të fuqisë punëtore [Origjinal]
11. Një përshkrim të përgjithshëm të objekteve dhe pajisjeve të organizatës [Origjinal]
12. Fushëveprimi i shërbimeve që do të ofrohen nën këtë certifikatë [Origjinal]
13. Procedura për amendamentimin e përshkrimit dhe të njoftimit të AAC-së për ndonjë ndryshim [Origjinal]

#### **2. Rekomandimet**

1. Kjo licencë të përcaktohet me ligj në kuptim e përshtatshmërisë me nenin 5 të LSLL;
2. Të përcaktohen me rregullore kritere të sakta dhe objektive për përcaktimin e afatit;

3. Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike;
4. Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio;
5. Të respektohet parimi i gjuhëve zyrtare;
6. Të krijohet një PVK në AAC;
7. Të caktohet me rregullore tarifa për aplikim

### **3. Arsyetimi i rekomandimeve**

1. **Kjo licencë të përcaktohet me ligj.** LSLL është ligj horizontal, në përputhje me të cilin Ligj duhet të jenë edhe ligjet e tjera. Në LAC dhe aktet përkatëse nënligjore duhet të adresohet kjo çështje dhe emërtimi të jetë në përputhje me LSLL. Po ashtu, nenit 17.1 i LSLL përcakton që licencat duhet të përcaktohen vetëm me ligj. Në rastin konkret, nuk mjafton vetëm baza ligjore materiale, si obligim për operatorin, respektivisht si kompetencë e AAC, por se, me LAC, specifikisht duhet të përcaktohet ky lloj i licencës. LAC nuk përmban dispozita për ndryshimin e kësaj leje dhe licence, andaj një gjë e tillë duhet të bëhet me ndryshimin e nenit 62 të LAC.
2. **Të përcaktohen me rregullore kritere të sakta dhe objektive për përcaktimin e afatit.** Përcaktimi i afatit për këtë licencë është me rëndësi për shkak të parimit të sigurisë juridike për aplikuesin, në kuptimin e qëndrueshmërisë dhe kohëzgjatjes. Andaj duhet të caktohen kritere objektive dhe të matshme në rregullore për sa i takon kohëzgjatjes së licencës. Kjo vije në shprehje sidomos kur licenca nuk ka afat të caktuar të kohëzgjatjes, sikur në këtë rast.
3. **Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike.** AAC duhet të aplikojë parimin e ndihmës administrative, përgjatë zhvillimit të procedurës dhe këtë ta bëjë të kombinuar me parimin e zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare. Përmes aplikimit të këtyre parimeve, AAC do të shambah dorëzimin e këtyre dokumenteve dhe do të lehtësojnë barrën administrative për aplikim.
4. **Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio.** Në rastet kur nuk është e mundur që kjo licencë të ipet pa afat të caktuar, ripërtërija e kësaj licence duhet të bëhet sipas detyrës zyrtare, përmes ndonjë procedurë të verifikimin ex-officio të fakteve dhe jo përmes një procedure të re administrative për aplikim. Kjo mund të përcaktohet me akt nënligjor nga ana e AAC. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton nenit 17.2 i LSLL.
5. **Të respektohet parimi i gjuhëve zyrtare.** Sipas nenit 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, gjuhë zyrtare në Kosovë janë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe. Në rastin konkret, vetëm dispozitat e përgjithshme në Rregulloren Nr. 5 / 2013 janë në Gjuhën Shqipe, derisa standardet ndërkombëtare dhe praktikat e rekomanduara janë vetëm në Gjuhën Angleze. Me qëllim të respektimit të gjuhëve zyrtare sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
6. **Të krijohet një PVK në AAC.** Një sportel i vetëm apo pikë e vetme e kontaktit duhet të krijohet në AAC, për sa i takon procedurës së aplikimit dhe shqyrimit të licencave dhe lejimeve tjera të AAC. Kjo pikë e vetme e kontaktit do të lehtësojë procedurën dhe do të koncentrojë kapacitetet shqyruese në këtë pikë. Po ashtu një gjë e tillë do të ndihmojë aplikuesit që në mënyrë efikase të fillojnë dhe përfundojnë procedurën si dhe gjithashtu, kjo do t'i ndihmoj edhe organin që më lehtësisht të shqyrtoj aplikimin. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton nenit 17.2 i LSLL.
7. **Të caktohet me rregullore tarifa për aplikim.** Në rregulloret e AAC lidhur me tarifa, nuk përcaktohet tarifa lidhur me këtë licencë. Referenca për tarifë është marrë nga të dhënat e ofruara nga AAC. Me qëllim të rritjet se sigurisë juridike, me akte nënligjore të AAC duhet të përcaktohet lartësia e tarifës për këtë shërbim. LSLL në nenin 18 përcakton një taksë proporcionale, për aq sa ajo është e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin. Në

përputhje me këtë parim duhet të jetë edhe niveli i taksës. Për më tepër, është e nevojshme që tarifa të jetë fiksë dhe mos të përcaktohet përmes elementeve dytësore që mundësojnë caktimin e tarifës. Një qasje e tillë ka potencial të paraqesë diskriminim apo pasiguri juridike. Për këtë arsy, AAC duhet të përcaktojë tarifa fiksë.

## 63.CERTIFIKIMI DHE LICENCIMI I PERSONELIT MJEKËSORE

### 1 Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës

Neni 37 i LAC njeh si lejime licencat e personelit të avionit, respektivisht personelit që duhet të ketë kualifikimin përkatës. Baza ligjore për lëshimin e kësaj licence janë nenet 37-39 të LAC. Neni 37 i LAC përcakton se “Çdo person i cili vepron si personel i avionit duhet të posedojë licencën dhe klasifikimin përkatës të lëshuar apo të shpallur te vlefshme nga AAC-ja sipas këtij Ligji dhe rregulloreve përkatëse të zbatimit. Klasifikimi nënkuption çdo shënim në licencë i cili i theksos kushtet, privilegjet apo kufizimet speciale. Kjo dispozitë aplikohet edhe për personelin e navigimit ajror dhe të mirëmbajtjes si dhe për zyrtarët e operimeve të fluturimit, operatorët e stacionit aeronautik dhe për instruktorët e fluturimit”, megjithatë nuk përmendet personeli mjekësor.

#### 1.1 Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca

Qëllimi i kësaj procedure administrative është certifikimi i personelit mjekësor për kontrollorët e trafikut ajror (sipas RQLL).

#### 1.2 Vlefshmëria kohore e lejes/licencës

N/A

#### 1.3 Pagesa për pajisjen me leje/licencë

N/A

#### 1.4 Dokumentet e nevojshme për aplikim

- 1 Formulari i kërkesës [Original]
- 2 Raporti i ekzaminimit mjekësor [Original]

### 2 Rekomandimet

- 1 Kjo licencë të përcaktohet me ligj në kuptimin e emërtimit;
- 2 Afati i licencës të përcaktohet me rregullore;
- 3 Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike;
- 4 Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio;
- 5 Të caktohet me rregullore tarifa për aplikim;
- 6 Të krijohet një PVK në AAC;

### 3 Arsyetimi i rekomandimeve

1. **Kjo licencë të përcaktohet me ligj në kuptimin e emërtimit.** LSLL është ligj horizontal, në përputhje me të cilin Ligj duhet të jenë edhe ligjet e tjera. Në LAC dhe aktet përkatëse nënligjore duhet të adresohet kjo çështje dhe emërtimi të jetë në përputhje me LSLL. Po ashtu, neni 17.1 i LSLL përcakton që licencat duhet të përcaktohen vetëm me ligj. LACC, nuk e njeh termin aprovim, në kuptim të nenit 67, andaj baza ligjore e kësaj leje dhe licence duhet të konkretizohet duke plotësuar nenin 67 të LACC.

2. **Afati i licencës të përcaktohet me rregullore.** Në rastin konkret, nuk është gjetur ndonjë dispozitë që flet lidhur me kohëzgjatjen e kësaj licence. Në përputhje me nenin 17 të LSLL dhe me qëllim të rritjes së sigurisë juridike, duhet të miratohen rregulla që përcaktojnë kohëzgjatjen e kësaj licence. Të caktohen kriteri objektive dhe të matshme në rregullore përsa i takon kohëzgjatjes së licencës.
3. **Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike.** AAC duhet të aplikojë parimin e ndihmës administrative, përgjatë zhvillimit të procedurës dhe këtë ta bëjë të kombinuar me parimin e zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare. Përmes aplikimit të këtyre parimeve, AAC do të shbang dorëzimin e këtyre dokumenteve dhe do të lehtësojnë barrën administrative për aplikim.
4. **Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio.** Në rastet kur nuk është e mundur që kjo licencë të ipet pa afat të caktuar, ripërërirja e kësaj licence duhet të bëhet sipas detyrës zyrtare, përmes ndonjë procedurë të verifikimin ex-officio të fakteve dhe jo përmes një procedure të re administrative për aplikim. Kjo mund të përcaktohet me akt nënligjor nga ana e AAC. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSLL.
5. **Të caktohet me rregullore tarifa për aplikim.** Në rregullohet e AAC lidhur me tarifa, nuk përcaktohet tarifa lidhur me këtë licencë. Referencia për tarifë është marrë nga të dhënat e ofruara nga AAC. Me qëllim të rritjet se sigurisë juridike, me akte nënligjore të AAC duhet të përcaktohet lartësia e tarifës për këtë shërbim. LSLL në nenin 18 përcakton një taksë proporcionale, për aq sa ajo është e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin. Në përputhje me këtë parim duhet të jetë edhe niveli i taksës. Për më tepër, është e nevojshme që tarifa të jetë fikse dhe mos të përcaktohet përmes elementeve dytësore që mundësojnë caktimin e tarifës. Një qasje e tillë ka potencial të paraqesë diskriminim apo pasiguri juridike. Për këtë arsy, AAC duhet të përcaktojë tarifa fikse.
6. **Të krijohet një PVK në AAC.** Një sportel i vetëm apo pikë e vetme e kontaktit duhet të krijohet në AAC, përsë i takon procedurës së aplikimit dhe shqyrtimit të licencave dhe lejimeve tjera të AAC. Kjo pikë e vetme e kontaktit do të lehtësojë procedurën dhe do të koncentrojë kapacitetet shqyrtuese në këtë pikë. Po ashtu një gjë e tillë do të ndihmojë aplikuesit që në mënyrë efikase të fillojnë dhe përfundojnë procedurën si dhe gjithashtu, kjo do t'i ndihmoj edhe organin që më lehtësish të shqyrtoj aplikimin. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSLL.

## 64.CERTIFIKIMI I AERODROMEVE - KLASA A

### 1. Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës

Neni 61.1 i LAC përcakton se “Çdo person i cili dëshiron të marrë përsipër operimin (drejtimin) e një Aerodromi duhet të aplikojë për marrjen e një certifikate të operimit nga AAC”. Mirëpo, LAC nuk përban dispozita lidhur me ndryshimin e Certifikatës se Aerodromit. Kështu, kjo licencë nuk përcaktohet me ligj. Rregullat që kanë të bëjnë me ndryshimin e certifikatës përcaktohen në Rregullore (AAC) nr. 06/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 17/2017 për dispozitat dhe procedurat administrative në lidhje me aerodromet dhe ne Rregulloren Nr.17/2017 për Dispozitat dhe Procedurat Administrative në lidhje me Aerodromet [ADR.AR.C.040 Ndryshimet].

#### 1.1. Veprimitaria për të cilën lëshohet leja/licenca

Qëllim i kësaj procedure është rregullimi i sigurisë së aerodromeve për shfrytëzim publik, në shërbim të operacioneve të transportit ajror nga operatorë ajror vendorë dhe ndërkombëtar dhe për dhënien e certifikatës së operimit të aerodromit për shfrytëzim publik, në shërbim të operacioneve të transportit ajror të operatorëve ajrorë vendorë dhe ndërkombëtar(sipas RQLL).

## **1.2. Vlefshmëria kohore e lejes/licencës**

Pesë (5) vite.

## **1.3. Pagesa për pajisjen me leje/licencë**

Certifikimi fillestar 20000 EUR.

Për ripërtëritje të certifikatës 10000 euro.

Për amendamendim/transferim të certifikatës 20000 Eur.

Pagesa vjetore 5000 Eur.

## **1.4. Dokumentet e nevojshme për aplikim**

1. Një kopje e Manualit të Aerodromit, adekuat me aktivitetet e pritshme të aeroplanëve në aerodrom [Origjinal]
2. Detajet e karakteristikave fizike të aerodromit, pajisjeve, shërbimeve dhe mjeteve, përfshirë edhe hartat aeronautike (harten e aerodromit dhe harten e pengesave) [Origjinal]
3. Kopja origjinale/vërtetuar të regjistrimit të biznesit [Origjinal]
4. Dëshmia mbi pronësinë e aerodromit apo të drejtës për shfrytëzim [Origjinal]
5. Të dhënat (CV) për stafin e lartë drejtues së aerodromit [Origjinal]
6. Dëshmia e pagesës së 50% të shumës së tarifës, në përputhje me rregulloren në fuqi për tarifat e ngarkuara nga AAC [Origjinal]

## **2. Rekomandimet**

1. Kjo licencë të përcaktohet me ligj;
2. Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike;
3. Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio;
4. Të rishikohet tarifa për aplikim;
5. Të krijohet një PVK në AAC;

## **3. Arsyetimi i rekomandimeve**

1. **Kjo licencë të përcaktohet me ligj.** LSLL është ligj horizontal, në përputhje me të cilin Ligj duhet të jenë edhe ligjet e tjera. Në LAC dhe aktet përkatëse nënligjore duhet të adresohet kjo çështje dhe emërtimi të jetë në përputhje me LSLL. Po ashtu, neni 17.1 i LSLL përcakton që licencat duhet të përcaktohen vetëm me ligj. Në rastin konkret, nuk mjafton vetëm baza ligjore materiale, si obligim për operatorin, respektivisht si kompetencë e AAC, por se, me LAC, specifikisht duhet të përcaktohet ky lloj i licencës. Ky rekomandim mund të zbatohet përmes ndryshimit të plotësimit të LAC.
2. **Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike.** AAC duhet të aplikojë parimin e ndihmës administrative, përgjatë zhvillimit të procedurës dhe këtë ta bëjë të kombinuar me parimin e zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare. Në rastin konkret, kjo mund të aplikohet lidhur me “Kopjen origjinale/të vërtetuar të regjistrimit të biznesit” dhe “dëshminë mbi

pronësinë e aerodromit apo të drejtës për shfrytëzim". Përmes aplikimit të këtyre parimeve, AAC do të shmag dorëzimin e këtyre dokumenteve dhe do të lehtësojnë barrën administrative për aplikim.

3. **Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio.** Në rastet kur nuk është e mundur që kjo licencë të ipet pa afat të caktuar, ripërërirja e kësaj licence duhet të bëhet sipas detyrës zyrtare, përmes ndonjë procedurë të verifikimin ex-officio të fakteve dhe jo përmes një procedure të re administrative për aplikim. Kjo mund të përcaktohet me akt nënligjor nga ana e AAC. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSLL.
4. **Të rishikohet tarifa për aplikim.** LSLL në ninin 18 përcakton një taksë proporcionale, për aq sa ajo është e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin. Në rastin konkret, pagesa prej 20.000 eurove duket se nuk ka ndjekur një qasje proporcionale. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSLL. Po ashtu, duhet të përcaktohet që e gjithë pagesa e taksës të bëhet vetëm pasi të lëshohet licenca dhe jo siç është aktualisht, që gjysma e tarifës duhet të paguhet me rastin e aplikimit.
5. **Të krijohet një PVK në AAC.** Një sportel i vetëm apo pikë e vetme e kontaktit duhet të krijohet në AAC, përsa i takon procedurës së aplikimit dhe shqyrtimit të licencave dhe lejimeve tjera të AAC. Kjo pikë e vetme e kontaktit do të lehtësojë procedurën dhe do të koncentrojë kapacitetet shqyrtuese në këtë pikë. Po ashtu një gjë e tillë do të ndihmojë aplikuesit që në mënyrë efikase të fillojnë dhe përfundojnë procedurën si dhe gjithash tu, kjo do t'i ndihmoj edhe organin që më lehtësisht të shqyrtoj aplikimin. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSLL.

## 65.CERTIFIKIMI I AERODROMEVE - KLASA B

### 1. Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës

Neni 61.1 i LAC përcakton se "Çdo person i cili dëshiron të marrë përsipër operimin (drejtimin) e një Aerodromi duhet të aplikojë për marrjen e një certifikate të operimit nga AAC". Mirëpo, LAC nuk përbën dispozita lidhur me ndryshimin e Certifikatës se Aerodromit. Kështu, kjo licencë nuk përcaktohet me ligj. Rregullat që kanë të bëjnë me ndryshimin e certifikatës përcaktohen në Rregullore (AAC) nr. 06/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 17/2017 për dispozitat dhe procedurat administrative në lidhje me aerodromet dhe ne Rregulloren Nr.17/2017 për Dispozitat dhe Procedurat Administrative në lidhje me Aerodromet [ADR.AR.C.040 Ndryshimet].

#### 1.1. Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca

Qëllim i kësaj procedure është rregullimi i sigurisë së aerodromeve për shfrytëzim publik, në shërbim të operacioneve të transportit ajror nga operatorë ajror vendorë dhe ndërkombëtar dhe dhëni e certifikatës së operimit të aerodromit për shfrytëzim publik, në shërbim të operacioneve të transportit ajror të operatorëve ajrorë vendorë dhe ndërkombëtar (sipas RQLL).

#### 1.2. Vlefshmëria kohore e lejes/licencës

Pesë (5) vite.

#### 1.3. Pagesa për pajisjen me leje/licencë

Certifikimi fillestar 10000 EUR.

Për ripërtëritje të certifikatës 5000 Eur.

Për amendamendim/transferim të certifikatës 10000 Eur.

Pagesa vjetore 2500 Eur.

#### **1.4. Dokumentet e nevojshme për aplikim**

1. Një kopje e Manualit të Aerodromit, adekuat me aktivitetet e pritshme të aeroplanëve në aerodrom
2. Detajet e karakteristikave fizike të aerodromit, pajisjeve, shërbimeve dhe mjeteve, përfshirë edhe hartat aeronautike (hartën e aerodromit dhe harten e pengesave) [Origjinal]
3. Kopja origjinale/e vërtetuar të regjistrimit të biznesit
4. Dëshmia mbi pronësinë e aerodromit apo të drejtës për shfrytëzim [Origjinal]
5. Të dhënat (CV) për stafin e lartë drejtues së aerodromit [Kopje]
6. Dëshmia e pagesës së 50% të shumës së tarifës, në përputhje me rregulloren në fuqi për tarifat e ngarkuara nga AAC [Origjinal]

#### **2. Rekomandimet**

1. Kjo licencë të përcaktohet me ligj;
2. Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike;
3. Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio;
4. Të rishikohet tarifa për aplikim;
5. Të krijohet një PVK në AAC;

#### **3. Arsyetimi i rekomandimeve**

1. **Kjo licencë të përcaktohet me ligj.** LSLL është ligj horizontal, në përputhje me të cilin Ligj duhet të jenë edhe ligjet e tjera. Në LAC dhe aktet përkatëse nënligjore duhet të adresohet kjo çështje dhe emërtimi të jetë në përputhje me LSLL. Po ashtu, neni 17.1 i LSLL përcakton që licencat duhet të përcaktohen vetëm me ligj. Në rastin konkret, nuk mjafton vetëm baza ligjore materiale, si obligim për operatorin, respektivisht si kompetencë e AAC, por se, me LAC, specifikisht duhet të përcaktohet ky lloj i licencës. Kjo sepse nuk ka dispozita konkrete në LAC që flasin për ndryshimin e kësaj licence. Andaj LAC duhet të plotësohet në nenin 62.
2. **Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike.** AAC duhet të aplikojë parimin e ndihmës administrative, përgjatë zhvillimit të procedurës dhe këtë ta bëjë të kombinuar me parimin e zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare. Në rastin konkret, kjo mund të aplikohet lidhur me “Kopjen origjinale/të vërtetuar të regjistrimit të biznesit” dhe “dëshminë mbi pronësinë e aerodromit apo të drejtës për shfrytëzim”. Përmes aplikimit të këtyre parimeve, AAC do të shhang dorëzimin e këtyre dokumenteve dhe do të lehtësojnë barrën administrative për aplikim.
3. **Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio.** Në rastet kur nuk është e mundur që kjo licencë të ipet pa afat të caktuar, ripërtërija e kësaj licence duhet të bëhet sipas detyrës zyrtare, përmes ndonjë procedurë të verifikimin ex-officio të fakteve dhe jo përmes një procedure të re administrative për aplikim. Kjo mund të përcaktohet me akt nënligjor nga ana e AAC. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSLL.
4. **Të rishikohet tarifa për aplikim.** LSLL në nenin 18 përcakton një taksë proporcionale, për aq sa ajo është e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin. Në rastin konkret, pagesa prej 10.000 eurove duket se nuk ka ndjekur një qasje proporcionale. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSLL. Po ashtu, duhet të përcaktohet që e gjithë pagesa e taksës të bëhet vetëm pasi të lëshohet licenca dhe jo siç është aktualisht, që gjysma e tarifës duhet të paguhet me rastin e aplikimit.
5. **Të krijohet një PVK në AAC.** Një sportel i vetëm apo pikë e vetme e kontaktit duhet të krijohet në AAC, përsë i takon procedurës së aplikimit dhe shqyrtimit të licencave dhe lejimeve tjera të AAC. Kjo pikë e vetme e kontaktit do të lehtësojë procedurën dhe do të koncentrojë kapacitetet shqyrtuese në këtë pikë. Po ashtu një gjë e tillë do të ndihmojë aplikuesit që në mënyrë efikase të fillojnë dhe

përfundojnë procedurën si dhe gjithashtu, kjo do t'i ndihmoj edhe organin që më lehtësisht të shqyrtoj aplikimin. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSLL.

## **66.CERTIFIKIMI I AERODROMEVE - KLASA C**

### **1. Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës**

Neni 61.1 i LAC përcakton se “Çdo person i cili dëshiron të marrë përsipër operimin (drejtimin) e një Aerodromi duhet të aplikojë për marrjen e një certifikate të operimit nga AAC”. Mirëpo, LAC nuk përbën dispozita lidhur me ndryshimin e Certifikatës se Aerodromit. Kështu, kjo licencë nuk përcaktohet me ligj. Rregullat që kanë të bëjnë me ndryshimin e certifikatës përcaktohen në Rregullore (AAC) nr. 06/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 17/2017 për dispozitat dhe procedurat administrative në lidhje me aerodromet dhe ne Rregulloren Nr.17/2017 për Dispozitat dhe Procedurat Administrative në lidhje me Aerodromet [ADR.AR.C.040 Ndryshimet].

#### **1.1. Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca**

Qëllim i kësaj procedure është rregullimi i sigurisë së aerodromeve për shfrytëzim publik, në shërbim të operacioneve të transportit ajror nga operatorë ajror vendorë dhe ndërkombëtar dhe dhëni e certifikatës së operimit të aerodromit për shfrytëzim publik, në shërbim të operacioneve të transportit ajror të operatorëve ajrorë vendorë dhe ndërkombëtar (sipas RQLL).

#### **1.2. Vlefshmëria kohore e lejes/licencës**

Pesë (5) vite.

#### **1.3. Pagesa për pajisjen me leje/licencë**

Certifikimi fillestar 5000 EUR.

Për ripërtëritje të certifikatës 2500 Eur.

Për amendamendim/transferim të certifikatës 5000 Eur.

Pagesa vjetore 1500 Eur.

#### **1.4. Dokumentet e nevojshme për aplikim**

1. Një kopje e Manualit të Aerodromit, adekuat me aktivitetet e pritshme të aeroplanoëve në aerodrom
2. Detajet e karakteristikave fizike të aerodromit, pajisjeve, shërbimeve dhe mjeteve, përfshirë edhe hartat aeronautike (harten e aerodromit dhe harten e pengesave) [Kopje]
3. Kopja origjinale/e vërtetuar të regjistrimit të biznesit
4. Dëshmia mbi pronësinë e aerodromit apo të drejtës për shfrytëzim [Origjinal]
5. Të dhënat (CV) për stafin e lartë drejtues së aerodromit [Kopje]
6. Dëshmia e pagesës së 50% të shumës së tarifës, në përputhje me rregulloren në fuqi për tarifat e ngarkuara nga AAC [Origjinal]

## **2.Rekomandimet**

1. Kjo licencë të përcaktohet me ligj;
2. Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike;
3. Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio;
4. Të rishikohet tarifa për aplikim;
5. Të krijohet një PVK në AAC;

### **3. Arsyetimi i rekomandimeve**

- 1. Kjo licencë të përcaktohet me ligj.** LSLL ështëligj horizontal, në përputhje me të cilin Ligj duhet të jenë edhe ligjet e tjera. Në LAC dhe aktet përkatëse nënligjore duhet të adresohet kjo çështje dhe emërtimi të jetë në përputhje me LSLL. Po ashtu, nenit 17.1 i LSLL përcakton që licencat duhet të përcaktohen vetëm me ligj. Në rastin konkret, nuk mjafton vetëm baza ligjore materiale, si obligim për operatorin, respektivisht si kompetencë e AAC, por se, me LAC, specifikisht duhet të përcaktohet ky lloj i licencës. LAC nuk përmban dispozita për ndryshimin e kësaj leje dhe licence, andaj një gjë e tillë duhet të bëhet me ndryshimin e nenit 62 të LAC.
- 2. Të rregullohet më specifikisht, se kush ka të drejtë të aplikojë për këtë licencë.** Ky rekomandim
- 3. Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike.** AAC duhet të aplikojë parimin e ndihmës administrative, përgjatë zhvillimit të procedurës dhe këtë ta bëjë të kombinuar me parimin e zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare. Në rastin konkret, kjo mund të aplikohet lidhur me “Kopjen origjinale/të vërtetuar të regjistrimit të biznesit” dhe “dëshminë mbi pronësinë e aerodromit apo të drejtës për shfrytëzim”. Përmes aplikimit të këtyre parimeve, AAC do të shhang dorëzimin e këtyre dokumenteve dhe do të lehtësojnë barrën administrative për aplikim.
- 4. Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio.** Në rastet kur nuk është e mundur që kjo licencë të ipet pa afat të caktuar, ripërtërija e kësaj licence duhet të bëhet sipas detyrës zyrtare, përmes ndonjë procedurë të verifikimin ex-officio të fakteve dhe jo përmes një procedure të re administrative për aplikim. Kjo mund të përcaktohet me akt nënligjor nga ana e AAC. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton nenit 17.2 i LSLL.
- 5. Të rishikohet tarifa për aplikim.** LSLL në nenin 18 përcakton një taksë proporcionale, për aq sa ajo është e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin. Në rastin konkret, pagesa prej 5.000 eurove duket se nuk ka ndjekur një qasje proporcionale. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton nenit 17.2 i LSLL. Po ashtu, duhet të përcaktohet që e gjithë pagesa e taksës të bëhet vetëm pasi të lëshohet licenca dhe jo siç është aktualisht, që gjysma e tarifës duhet të paguhet me rastin e aplikimit.
- 6. Të krijohet një PVK në AAC.** Një sportel i vetëm apo pikë e vetme e kontaktit duhet të krijohet në AAC, përsë i takon procedurës së aplikimit dhe shqyrimit të licencave dhe lejimeve tjera të AAC. Kjo pikë e vetme e kontaktit do të lehtësojë procedurën dhe do të koncentrojë kapacitetet shqyruese në këtë pikë. Po ashtu një gjë e tillë do të ndihmojë aplikuesit që në mënyrë efikase të fillojnë dhe përfundojnë procedurën si dhe gjithashtu, kjo do t'i ndihmoj edhe organin që më lehtësisht të shqyrtoj aplikimin. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton nenit 17.2 i LSLL.

## **67. CERTIFIKIMI I EKZAMINUESËVE TË AUTORIZUAR MJEKËSOR**

### **1. Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës**

Kjo licencë nuk është e përcaktuar me LAC. Megjithatë, nenit 37 i LAC njeh si lejime licencat e personelit të aviacionit, respektivisht personelit që duhet të ketë kualifikimin përkatës. Baza ligjore për lëshimin e kësaj licence janë nenit 37-39 të LAC. Neni 37 i LAC përcakton se “Çdo person i cili vepron si personel i aviacionit duhet të posedojë licencën dhe klasifikimin përkatës të lëshuar apo të shpallur te vlefshme nga AAC-ja sipas këtij Ligji dhe rregulloreve përkatëse të zbatimit. Klasifikimi nënkuption çdo shënim në licencë i cili i thekson kushtet, privilegjet apo kufizimet speciale. Kjo dispozitë aplikohet edhe për personelin e navigimit ajror dhe të mirëmbajtjes si dhe për zyrtarët e operimeve të fluturimit, operatorët e stacionit aeronautik dhe për instruktorët e fluturimit”, megjithatë nuk përmendet personeli mjekësor apo edhe ekzaminuesi i autorizuar mjekësor. Dispozitat që kanë të bëjnë me këtë licencë janë pjesë e Rregullores (AAC) nr. 04/2022 për ndryshimin e rregullores (AAC) nr. 05/2015 që përcakton kriteret

teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil në përputhje me rregulloren (AAC) nr. 05/2020.

### **1.1. Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca**

Qëllimi i kësaj procedure është krijimi i kushteve sa më adekuate për kujdesin shëndetësore të punëtorëve të involvuar në operimet me mjete ajrore (sipas RQLL).

### **1.2. Vlefshmëria kohore e lejes/licencës**

Tre (3) vite.

### **1.3. Pagesa për pajisjen me leje/licencë**

N/A

### **1.4. Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

1. Kërkesë për aprovimin e ekzaminerëve të autorizuar mjekësor [Origjinal]
2. Diploma e edukimit përkatës [Origjinal]

### **2. Rekomandimet**

1. Kjo licencë të përcaktohet me ligj;
2. Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio;
3. Të krijohet një PVK në AAC;
4. Veprimtaria e licencave të përcaktohet me akte nënligjore;
5. Të caktohet me rregullore tarifa për aplikim.
6. Afati i licencës të përcaktohet me rregullore.

### **3.Arsyetimi i rekomandimeve**

1. **Kjo licencë të përcaktohet me ligj.** LSLL është ligj horizontal, në përputhje me të cilin Ligj duhet të jenë edhe ligjet e tjera. Në LAC dhe aktet përkatëse nënligjore duhet të adresohet kjo çështje dhe emërtimi të jetë në përputhje me LSLL. Po ashtu, neni 17.1 i LSLL përcakton që licencat duhet të përcaktohen vetëm me ligj. Në rastin konkret, nuk mjafton vetëm baza ligjore materiale, si obligim për operatorin, respektivisht si kompetencë e AAC, por se, me LAC, specifikisht duhet të përcaktohet ky lloj i licencës. LAC nuk përmban dispozita për ndryshimin e kësaj leje dhe licence, andaj një gjë e tillë duhet të bëhet me ndryshimin e nenit 62 të LAC.
2. **Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio.** Në rastet kur nuk është e mundur që kjo licencë të ipet pa afat të caktuar, ripërtërija e kësaj licence duhet të bëhet sipas detyrës zyrtare, përmes ndonjë procedurë të verifikimin ex-officio të fakteve dhe jo përmes një procedure të re administrative për aplikim. Kjo mund të përcaktohet me akt nënligjor nga ana e AAC. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSLL.
3. **Të krijohet një PVK në AAC.** Një sportel i vetëm apo pikë e vetme e kontaktit duhet të krijohet në AAC, për sa i takon procedurës së aplikimit dhe shqyrimit të licencave dhe lejimeve tjera të AAC. Kjo pikë e vetme e kontaktit do të lehtësojë procedurën dhe do të koncentrojë kapacitetet shqyruese në këtë pikë. Po ashtu një gjë e tillë do të ndihmojë aplikuesit që në mënyrë efikase të fillojnë dhe përfundojnë procedurën si dhe gjithashtu, kjo do t'i ndihmoj edhe organin që më lehtësisht të shqyrtoj aplikimin. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSLL.

- 4. Veprimtaria e licencave të përcaktohet me akte nënligjore:** Bazuar në nenin 17.2 të LSLL, rekomandohet që me rastin e nxjerjes së rregulloreve të veçanta procedurale, për secilën leje dhe licencë të përcaktohet më saktësisht veprimtaria e tyre.
- 5. Të caktohet me rregullore tarifa për aplikim:** Në rregullohet e AAC lidhur me tarifa, nuk përcaktohet tarifa lidhur me këtë licencë. Referenca për tarifë është marrë nga të dhënat e ofruara nga AAC. Me qëllim të rritjet se sigurisë juridike, me akte nënligjore të AAC duhet të përcaktohet lartësia e tarifës për këtë shërbim. LSLL në nenin 18 përcakton një taksë proporcionale, për aq sa ajo është e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin. Në përputhje me këtë parim duhet të jetë edhe niveli i taksës. Për më tepër, është e nevojshme që tarifa të jetë fikse dhe mos të përcaktohet përmes elementeve dytësore që mundësojnë caktimin e tarifës. Një qasje e tillë ka potencial të paraqesë diskriminim apo pasiguri juridike. Për këtë arsy, AAC duhet të përcaktojë tarifa fikse.
- 6. Afati i licencës të përcaktohet me rregullore:** Në rastin konkret, afati është marrë nga të dhënat e ofruara nga AAC. Mirëpo, në rregullativën e AAC, nuk është gjetur ndonjë dispozitë që flet lidhur me kohëzgjatjen e kësaj licence. Në përputhje me nenin 17 të LSLL dhe me qëllim të rritjes së sigurisë juridike, duhet të miratohen rregulla që përcaktojnë kohëzgjatjen e kësaj licence.

## 68.CERTIFIKIMI I HELIPORTEVE

### 1.Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës

Kjo lloj licence nuk është e përcaktuar në ligj. Neni 61.1 i LAC përcakton se “Çdo person i cili dëshiron të marrë përsipër operimin (drejtimin) e një Aerodromi duhet të aplikojë për marrjen e një certifikate të operimit nga AAC”. Mirëpo, LAC nuk përmban dispozita lidhur me ndryshimin e Certifikatës se Aerodromit. Kështu, kjo licencë nuk përcaktohet me ligj. Rregullat që kanë të bëjnë me ndryshimin e certifikatës përcaktohen në Rregullore (AAC) nr. 06/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 17/2017 për dispozitat dhe procedurat administrative në lidhje me aerodromet dhe ne Rregulloren Nr.17/2017 për Dispozitat dhe Procedurat Administrative në lidhje me Aerodromet [ADR.AR.C.040 Ndryshimet]. Sipas Rregullore nr. 3/2014 mbi ngritjen dhe aterrimin e helikopterëve jashtë zonave të aerodromeve, përkatesisht nenit 2: **“Aerodrom” nënkupton zonën e përcaktuar në tokë (duke përfshirë ndërtesat, instalimet dhe pajisjet) të cilat përdoren plotësisht apo pjesërisht në aterrime, ngritje dhe lëvizjet e avionëve. Në këtë rregullore, termi Aerodrom përfshin heliportet, fusha të aterrimit dhe fusha të veloreve.; “Heliport” nënkupton një aerodrom apo një zonë të caktuar në ndonjë strukturë që ka për qëllim të shfrytëzohet plotësisht apo pjesërisht për ngritje, aterrime dhe lëvizje të helikopterëve;**

#### 1.1. Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca

Qëllim i kësaj procedure administrative është dhënia e certifikatës së operimit të heliportit për shfrytëzim publik, në shërbim të operacioneve të transportit ajror të operatorëve ajrorë vendorë dhe ndërkombëtar (sipas RQLL).

#### 1.2. Vlefshmëria kohore e lejes/licencës

Pesë (5) vite.

#### 1.3. Pagesa për pajisjen me leje/licencë

Certifikimi fillestar 5000 EUR.

Per riperteritje te certifikates 2500 Eur.

Per amendamendim/transferim te certifikates 5000 Eur.

Pagesa vjetore 1250 Eur.

#### **1.4. Dokumentet e nevojshme për aplikim**

1. Një kopje e Manualit të Heliportit, adekuat me aktivitetet e pritshme të helikopterëve në heliport
2. Detajet e karakteristikave fizike të heliportit, pajisjeve, shërbimeve dhe mjeteve, përfshirë edhe hartat aeronautike (hartën e heliportit dhe hartën e pengesave) [Original]
3. Kopja origjinale/e vërtetuar të regjistrimit të biznesit
4. Dëshmia mbi pronësinë e heliportit apo të drejtës për shfrytëzim [Original]
5. Të dhënat (CV) për stafin e lartë drejtues së heliportit [Kopje]
6. Dëshmia e pagesës së 50% të shumës së tarifës, në përputhje me rregulloren në fuqi për tarifat e ngarkuara nga AAC [Original]

#### **2. Rekomandimet**

1. Kjo licencë të përcaktohet me ligj;
2. Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike;
3. Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio;
4. Të rishikohet tarifa për aplikim;
5. Të krijohet një PVK në AAC;

#### **3. Arsyetimi i rekomandimeve**

1. **Kjo licencë të përcaktohet me ligj.** LSLL ështëligj horizontal, në përputhje me të cilin Ligj duhet tëjenë edhe ligjet e tjera. Në LAC dhe aktet përkatëse nënligjore duhet të adresohet kjo çështje dhe emërtimi të jetë në përputhje me LSLL. Po ashtu, neni 17.1 i LSLL përcakton që licencat duhet të përcaktohen vetëm me ligj. Në rastin konkret, nuk mjafton vetëm baza ligjore materiale, si obligim për operatorin, respektivisht si kompetencë e AAC, por se, me LAC, specifikisht duhet të përcaktohet ky lloj i licencës. LAC nuk përmban dispozita për ndryshimin e kësaj leje dhe licence, andaj një gjë e tillë duhet të bëhet me ndryshimin e nenit 62 të LAC.
2. **Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike.** AAC duhet të aplikojë parimin e ndihmës administrative, përgjatë zhvillimit të procedurës dhe këtë ta bëjë të kombinuar me parimin e zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare. Në rastin konkret, kjo mund të aplikohet lidhur me “Kopjen origjinale/të vërtetuar të regjistrimit të biznesit” dhe “dëshminë mbi pronësinë e aerodromit apo të drejtës për shfrytëzim”. Përmes aplikimit të këtyre parimeve, AAC do të shhang dorëzimin e këtyre dokumenteve dhe do të lehtësojnë barrën administrative për aplikim.
3. **Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio.** Në rastet kur nuk është e mundur që kjo licencë të ipet pa afat të caktuar, ripërtërija e kësaj licence duhet të bëhet sipas detyrës zyrtare, përmes ndonjë procedurë të verifikimin ex-officio të fakteve dhe jo përmes një procedure të re administrative për aplikim. Kjo mund të përcaktohet me akt nënligjor nga ana e AAC. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSLL.
4. **Të rishikohet tarifa për aplikim.** LSLL në nenin 18 përcakton një taksë proporcionale, për aq sa ajo është e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin. Në rastin konkret, pagesa prej 5.000 eurove duket se nuk ka ndjekur një qasje proporcionale. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSLL. Po ashtu, duhet të përcaktohet që e gjithë pagesa e taksës të bëhet vetëm pasi të lëshohet licenca dhe jo siç është aktualisht, që gjysma e tarifës duhet të paguhet me rastin e aplikimit.
5. **Të krijohet një PVK në AAC.** Një sportel i vetëm apo pikë e vetme e kontaktit duhet të krijohet në AAC, përsa i takon procedurës së aplikimit dhe shqyrtimit të licencave dhe lejimeve tjera të AAC. Kjo

pikë e vetme e kontaktit do të lehtësojë procedurën dhe do të koncentrojë kapacitetet shqyruese në këtë pikë. Po ashtu një gjë e tillë do të ndihmojë aplikuesit që në mënyrë efikase të fillojnë dhe përfundojnë procedurën si dhe gjithashtu, kjo do t'i ndihmoj edhe organin që më lehtësisht të shqyrtoj aplikimin. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSLL.

## 69.CERTIFIKIMI I OFRUESIT TË SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR

### 1. Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës

Kjo licencë nuk parashihet me LAC. Një dispozita e përgjithshme që flet për Rregullimin e shërbimeve të Navigimit Ajror është neni 79 i LAC, që përcakton se “Rregullimi i shërbimeve të navigimit ajror, kur është e aplikueshme, duhet të bëhet në përputhje me rregullat e ONAC, BE/HPEA, AESA dhe EUROCONTROL-it. AAC do të nxjerrë rregullore të cilat bazohen ose të cilat janë në përputhje me rregullat e organizatave të sipër cekura, lidhur me ofrimin e shërbimeve vendore të navigimit ajror. Rregullat që kanë të bëjnë me certifikimin e Ofruesve të Shërbimeve të Navigimit Ajror, që kryesisht paraqesin autorizim për AAC për rregullim të mëtutjeshëm me akte nënligjore, janë të përcaktuara në pjesën 5 të LAC. Sa i përket akteve nënligjore, dispozitat që kanë të bëjnë me këtë licencë janë të përcaktuara në Rregulloren (AAC) Nr. 09/2020 për përcaktimin e kërkeseve të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/navigimit ajror dhe funksioneve tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre. Dhe në Rregulloren e AAC Nr. 19/2017 që përcakton kërkesa teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror. Licenca është në kundërshtim me nenin 17.1 të LSLL.

#### 1.1. Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca

Qellimi i kësaj procedure është sigurimi se një ofrues i shërbimeve të navigacionit ajror, ofron një shërbim të sigurt, cilësor dhe efikas në bazë të rregullave dhe standardeve më të larta për siguri në aviacionin civil, sipas ligjit për aviacionin civil (sipas RQLL).

#### 1.2. Vlefshmëria kohore e lejes/licencës

E pa definuar saktësisht. Koha minimale është 2 vite, ndërsa maksimale është 6 vite.

#### 1.3. Pagesa për pajisjen me leje/licencë

20,000.00 € Lëshimi i certifikatës,  
10,000.00 € Ripërtrirja e certificates

#### 1.4. Dokumentet e nevojshme për aplikim:

1. Një deklaratë të nënshkruar nga Kryeshefi Ekzekutiv apo ekuivalent që konfirmon se organizata dhe çdo dokumentacion referues i cekur definon përputhshmërinë aktuale dhe në vazhdimësi, të organizatës me të gjitha Kërkesa e aplikueshme dhe pajtohet që t'i ofroj AAC-së çdo informatë për vlerësimin e përshkrimit [Origjinal]
2. Politika e organizatës për siguri në pajtim me direktivat e Kërkeseve të Përbashkëta; [Origjinal]
3. Titujt e pozitave dhe emrat e menaxhmentit të lartë; [Origjinal]
4. Një strukturë organizative që tregon linjën e përgjegjësive të menaxhmentit në fushat e mbuluara nga Kërkesa e Përbashkëta; [Origjinal]
5. Një strukturë organizative që tregon linjën e përgjegjësive të menaxhmentit në fushat e mbuluara nga Kërkesa e Përbashkëta; [Origjinal]
6. Një përshkrim të përgjithshëm të resurseve të fuqisë punëtore [Origjinal]
7. Një përshkrim të përgjithshëm të objekteve dhe pajisjeve të organizatës [Origjinal]

8. Fushëveprimi i shërbimeve që do të ofrohen nën këtë certifikatë [Original]
9. Procedura për amendamentimin e përshkrimit dhe të njoftimit të AAC-së për ndonjë ndryshim; [Original]

## **2. Rekomandimet**

1. Kjo licencë të përcaktohet me ligj;
2. Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio;
3. Të krijohet një PVK në AAC;
4. Të rishqyrtohet taksa;
5. Të hartoher një rregullore e veçantë për procedurën dhe kriteret e lëshimit të aprovimeve;
6. Të përcaktohet nëse për këtë licencë kanë të drejtë të aplikojnë peronat fizik ose juridik.

## **3. Arsyetimi i rekomandimeve**

1. **Kjo licencë të përcaktohet me ligj:** LSLL është ligj horizontal, në përputhje me të cilin Ligj duhet të jenë edhe ligjet e tjera. Në LAC dhe aktet përkatëse nënligjore duhet të adresohet kjo çështje dhe emërtimi të jetë në përputhje me LSLL. Po ashtu, neni 17.1 i LSLL përcakton që licencat duhet të përcaktohen vetëm me ligj. Në rastin konkret, nuk mjafton vetëm baza ligjore materiale, si obligim për operatorin, respektivisht si kompetencë e AAC, por se, me LAC, specifisht duhet të përcaktohet ky lloj i licencës. LAC nuk përmban dispozita për ndryshimin e kësaj leje dhe licence, andaj një gjë e tillë duhet të bëhet me ndryshimin e nenit 62 të LAC.
2. **Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio:** Në rastet kur nuk është e mundur që kjo licencë të jepet pa afat të caktuar, ripërtërija e kësaj licence duhet të bëhet sipas detyrës zyrtare, përmes ndonjë procedurë të verifikimin ex-officio të fakteve dhe jo përmes një procedure të re administrative për aplikim. Kjo mund të përcaktohet me akt nënligjor nga ana e AAC. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSLL.
3. **Të krijohet një PVK në AAC:** Një sportel i vetëm apo pikë e vetme e kontaktit duhet të krijohet në AAC, për sa i takon procedurës së aplikimit dhe shqyrtimit të licencave dhe lejimeve tjera të AAC. Kjo pikë e vetme e kontaktit do të lehtësojë procedurën dhe do të koncentrojë kapacitetet shqyrtuese në këtë pikë. Po ashtu një gjë e tillë do të ndihmojë aplikuesit që në mënyrë efikase të fillojnë dhe përfundojnë procedurën si dhe gjithashtu, kjo do t'i ndihmoj edhe organin që më lehtësisht të shqyrtoj aplikimin. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSLL.
4. **Të rishqyrtohet taksa.** LSLL në ninin 18 përcakton një taksë proporcionale, për aq sa ajo është e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin. Në përputhje me këtë parim duhet të jetë edhe niveli i takṣës. Në rastin konkret, taksa prej 20.000 eurove për lëshimin e kësaj licence nuk duket të jetë në përputhje me këtë parim. Po ashtu, duhet që të bëhet edhe heqja e takṣës së rishikimit, me rastin e kësaj licence.
5. **Të hartoher një rregullore e veçantë për procedurën dhe kriteret e lëshimit:** Me qëllim të uniformimit të procedurave të aplikimit për këtë licencë, kritereve për këtë licencë, dokumentet e nevojshëm dhe çështjet e tjera të shqyrtimit, konform LPPA, rekamandohet të nxjerrët një rregullore e veçantë për procedurën dhe kriteret e lëshimit. Një rregullore e tillë, në të cilën do të ndihmonte AAC për ti jetësuar parimet e LPPA dhe LSLL, në lehtësimin e procedurave për lëshimin e kësaj leje dhe licence si dhe do ti ndihmonte palët që në mënyrë efikase të informoheshin për procedurat, kriteret dhe aspektet e tjera për lëshimin në fjalë.
6. **Të përcaktohet nëse për këtë licencë kanë të drejtë të aplikojnë peronat fizik ose juridik.** Nuk është e përcaktuar me LAC dhe rregullore se për këtë licencë kush mund të aplikojë. Andaj është e udhës të qartësitet me ligj, se për cilat licenca aplikojnë personat fizik e për cilat aplikojnë peronat juridik.

## **70.CERTIFIKIMI I OPERATOREVE AJROR PËR PUNË NGA AJRI**

### **1. Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës**

Kjo licencë nuk parashihet specifisht me LAC. Baza ligjore për Certifikatë të Operatorit Ajror (e ku mund te hynë edhe certifikimi i operatoreve ajror per pune nga ajri) është nen 32 i LAC, që përcakton se “Çdo shtetas i Republikës së Kosovës i cili dëshiron të angazhohet në veprimtari (operacione) ajrore në Kosovë duhet të marrin dhe të posedojnë një Certifikatë të Operatorit Ajror (“COA”) aktuale dhe të vlefshme, të lëshuar nga AAC-ja”. Po ashtu, lidhur me këtë licencë, LAC në nenin 33 përcakton se “1. Të gjitha kushtet për marrjen e COA do të përcaktohen nga AAC në një rregullore për zbatim të nxjerrë në bazë të autorizimit të këtij ligji. 2. AAC duhet të sigurojë që këto rregullore t’i përm bushin kushtet e zbatueshme të HPEA dhe AESA”.

#### **1.1. Veprimitaria për të cilën lëshohet leja/licenca**

Qëllimi i kësaj procedure është përshkrimi dhe thjeshtëzimi i procesit, si dhe kontrolli dhe vlerësimi e dokumenteve të kërkua të operatorëve për punë nga ajri. Kontrollimi i dokumenteve është i nevojshëm për të siguruar saktësinë e punës (sipas RQLL).

#### **1.2. Vlefshmëria kohore e lejes/licencës**

Pa afat.

#### **1.3. Pagesa për pajisjen me leje/licencë**

1. Transporti ajror komercial - më pak se 2730 kg 400.00 Euro;
2. Transporti ajror komercial - prej 2730 kg deri në 5700 kg 1,500.00 Euro);
3. Avioni komercial - prej 5700 kg deri në 40000kg 3,000.00 Euro;
4. Avioni komercial - më shumë se 40000 kg 4,000.00 Euro.

#### **1.4. Dokumentet e nevojshme për aplikim**

1. Aplikacioni për Certifikatë të Operatorit Ajrore AOC për punë nga ajri [Origjinal]
2. Kërkesa për aprovime speciale [Origjinal]
3. Informata kontaktuese të aplikuesit/operatorit [Origjinal]
4. Manualin e Operimeve (OM A, B, C, D, GOM dhe QS) [Origjinal]
5. Kontratat për Leasing të Aeroplaneve/Helikopterive [Origjinal]
6. Kontrata për mirëmbajtje [Origjinal]
7. Kontrata me qendër trajnimi për trajnim të Ekuipazhit të Fluturimit dhe Kabinës (nëse ka) [Origjinal]
8. Lista e Menaxherëve Kryesor dhe Zëvendësit e tyre (AACK-EASA Form 4) [Origjinal]

### **2.Rekomandimet**

1. Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike;
2. Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio;
3. Të krijohet një PVK në AAC;
4. Të hartohet një rregullore e veçantë për procedurën dhe kriteret e lëshimit të licencave.
5. Të caktohet me rregullore tarifa për aplikim
6. Emërtimi i kësaj licence të harmonizohet me LAC
7. Veprimitaria e licencës të përcaktohet me akte nënligjore

### **3.Arsyetimi i rekomandimeve**

- 1. Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike.** AAC duhet të aplikojë parimin e ndihmës administrative, përgjatë zhvillimit të procedurës dhe këtë ta bëjë të kombinuar me parimin e zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare. Përmes aplikimit të këtyre parimeve, AAC do të shhang dorëzimin e këtyre dokumenteve dhe do të lehtësojnë barrën administrative për aplikim.
- 2. Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio.** Në rastet kur nuk është e mundur që kjo licencë të jepet pa afat të caktuar, ripërtërija e kësaj licence duhet të bëhet sipas detyrës zyrtare, përmes ndonjë procedurë të verifikimin ex-officio të fakteve dhe jo përmes një procedure të re administrative për aplikim. Kjo mund të përcaktohet me akt nënligjor nga ana e AAC. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSLL.
- 3. Të krijohet një PVK në AAC.** Një sportel i vetëm apo pikë e vetme e kontaktit duhet të krijohet në AAC, për sa i takon procedurës së aplikimit dhe shqyrtimit të licencave dhe lejimeve tjera të AAC. Kjo pikë e vetme e kontaktit do të lehtësojë procedurën dhe do të koncentrojë kapacitetet shqyrtuese në këtë pikë. Po ashtu një gjë e tillë do të ndihmojë aplikuesit që në mënyrë efikase të fillojnë dhe përfundojnë procedurën si dhe gjithashtu, kjo do t'i ndihmoj edhe organin që më lehtësish të shqyrtoj aplikimin. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSLL.
- 4. Të hartoher një rregullore e veçantë për procedurën dhe kriteret e lëshimit të licencave.** Me qëllim të uniformimit të procedurave të aplikimit për këtë licencë, kriterete për këtë licencë, dokumentet e nevojshëm dhe çështjet e tjera të shqyrtimit, komfor LPPA, rekomandohet të nxjerrët një rregullore e veçantë për procedurën dhe kriteret e lëshimit të aprovimeve. Një rregullore e tillë, në të cilën do të ndihmonte AAC për ti jetësuar parimet e LPPA dhe LSLL, në lehtësimin e procedurave për lëshimin e kësaj leje dhe licence si dhe do ti ndihmonte palët që në mënyrë efikase të informoheshin për procedurat, kriteret dhe aspektet e tjera për lëshimin e aprovimit në fjalë.
- 5. Të caktohet me rregullore tarifa për aplikim.** Në rregulloret e AAC lidhur me tarifa, nuk përcaktohet tarifa lidhur me këtë licencë. Referenca për tarifë është marrë nga të dhënat e ofruara nga AAC. Me qëllim të rritjet se sigurisë juridike, me akte nënligjore të AAC duhet të përcaktohet lartësia e tarifës për këtë shërbim. LSLL në nenin 18 përcakton një taksë proporcionale, për aq sa ajo është e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin. Në përpunje me këtë parim duhet të jetë edhe niveli i taksës. Për më tepër, është e nevojshme që tarifa të jetë fiksë dhe mos të përcaktohet përmes elementeve dytësore që mundësojnë caktimin e tarifës. Një qasje e tillë ka potencial të paraqesë diskriminim apo pasiguri juridike. Për këtë arsy, AAC duhet të përcaktojë tarifa fiksë.
- 6. Emërtimi i kësaj licence të harmonizohet me LAC:** Në nenin 5 të LSLL përcakton llojet e lejimeve. Në rastin konkret bëhet fjalë për lejime jo licencë, por megjithatë kalon në procedurë të miratimit. Andaj, një gjë e tillë duhet të bëhet sipas emërtimeve që i ka përcaktua neni 5 i LSLL, si njoftim, regjistrim leje etj.
- 7. Veprimitaria e licencave të përcaktohet me akte nënligjore:** Bazuar në nenin 17.2 të LSLL, rekomandohet që me rastin e nxjerjes së rregulloreve të veçanta procedurale, për secilën leje dhe licencë të përcaktohet më saktësisht veprimitaria e tyre.

## **71.LEJE PËR TRANSPORT TË ARMËVE, PJESËVE TË ARMËVE DHE MUNICIONIT**

### **1. Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës**

Baza ligjore për këtë leje është e bazuar ne Ligji nr. 05/l -022 për armë, ne nenin 24, paragrafi 1 (1.6): "Lejet për personat juridik janë: 1.6. leja për transport të armëve;" dhe nenin 30, paragrafi 1: "Për çdo

*transportim të armëve, pjesëve të armëve dhe municionit nevojitet leje nga organi kompetent” .Kjo licencë nuk parashihet me LAC. Dispozitat që kanë të bëjnë me mallrat e rrezikshme, janë nenet 57-59 të LAC.*

**1.1. Veprimitaria për të cilën lëshohet leja/licenca:**

Qëllimi i kësaj procedure është rregullimi i tregut të transportit të armëve dhe municionit për personat juridik (sipas RQLL).

**1.2. Vlefshmëria kohore e lejes/licencës:**

90 ditë.

**1.3. Pagesa për pajisjen me leje/licencë:**

500 euro.

**1.4. Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

1. Dëshminë nga organi kompetent që posedojnë hapsirë për ruajtjen dhe vendosjen e sigurtë të armës së zjarrit dhe municionit [Kopje]
2. Certifikatën e regjistrimit të biznesit [Kopje]
3. Vërtetimin gjyqësor që puna e personit juridik nuk ndalohet ose ndërpritet me vendim të formës së prerë të gjykatës kompetente; [Original]
4. Verifikimi i së kaluarës për subjektin aplikues, themeluesit e tij, pronarët dhe personat përgjegjës [Original]

**2. Rekomandimet**

1. Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike;
2. Të caktohet me rregullore tarifa për aplikim (sipas nevojave te AAC-se);

**3. Arsyetimi i rekomandimeve**

1. **Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike.** AAC duhet të aplikojë parimin e ndihmës administrative, përgjatë zhvillimit të procedurës dhe këtë ta bëjë të kombinuar me parimin e zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare. Në rastin konkret, kjo mund të aplikohet lidhur me “Certifikatën e regjistrimit të biznesit” Përmes aplikimit të këtyre parimeve, AAC do të shhang dorëzimin e këtyre dokumenteve dhe do të lehtësojnë barrën administrative për aplikim.
2. **Të caktohet me rregullore tarifa për aplikim.** Në rregullohet e AAC lidhur me tarifa, nuk përcaktohet tarifa lidhur me këtë licencë. Referencia për tarifë është marrë nga të dhënat e ofruara nga AAC. Me qëllim të rritjet se sigurisë juridike, me akte nënligjore të AAC duhet të përcaktohet lartësia e tarifës për këtë shërbim. LSLL në nenin 18 përcakton një taksë proporcionale, për aq sa ajo është e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin. Në përputhje me këtë parim duhet të jetë edhe niveli i taksës. Për më tepër, është e nevojshme që tarifa të jetë fiksë dhe mos të përcaktohet përmes elementeve dytësore që mundësojnë caktimin e tarifës. Një qasje e tillë ka potencial të paraqesë diskriminim apo pasiguri juridike. Për këtë arsy, AAC duhet të përcaktojë tarifa fiksë.

## **72.RIPËRTËRITJE E CERTIFIKATËS PËR BARTJEN E MALLRAVE TE RREZIKSHME**

### **1. Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës**

Kjo licencë nuk parashihet me LAC. Dispozitat që kanë të bëjnë me mallrat e rrezikshme, janë nenet 57-59 të LAC. Dispozitat që kanë të bëjnë me këtë licencë janë pjesë e Rregullores së AAC NR. 04/2020 për kushtet dhe metodat e transportit të mallrave të rrezikshme përmes ajrit. Neni 15.1. i kësaj Rregullore përcakton se “Mallrat e rrezikshme pranohen dhe përcillen nga dërguesit e mallrave, transportuesit, ofruesit e shërbimeve të cilët pranojnë dhe dërgojnë ngarkesa, dhe operatorët e caktuar postar, të cilëve AACK-ja ka lëshuar Certifikatë për Mallra të Rrezikshme”.

#### **1.1. Veprimitaria për të cilën lëshohet leja/licenca**

Qëllimi i kësaj procedure është përcaktimi se mallrat e rrezikshme duhet të pranohen dhe përcillen vetëm nga ato subjekte (dërguesit, shpediterët, ofruesit e shërbimit të trajtimit në tokë, agjentët e trajtimit të mallrave dhe operatorët) të cilave AACK u ka lëshuar certifikatë si kompetente për të kryer këto operime, dhe të cilat janë në posedim të një certifikate të vlefshëm për mallrat e rrezikshme (sipas RQLL).

#### **1.2. Vlefshmëria kohore e lejes/licencës**

Pa afat.

#### **1.3. Pagesa për pajisjen me leje/licencë**

500 euro.

#### **1.4 Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

1. Organografi i organizatës [Origjinal]
2. Procedurat Standarde të Veprimit (ose dokument tjetër relevant) që përshkruajnë një proces të detajuar të pranimit dhe trajtimit të ngarkesave dhe / ose ngarkesave të mallrave të rrezikshme. [Origjinal]
3. Lista e të punësuarve që janë në posedim të certifikatave të mallrave të vlefshme për mallrat e rrezikshme (për kategoritë 1, 2, 3 dhe 6) në përputhje me dispozitën 1; 4.2 (Tabela 1-4) e udhëzimeve teknike [Origjinal]
4. Kopja e certifikatave të vlefshme DG për punonjësit të referuar në 4.3
5. Certifikata e Operatorit Ajror (AOC) (nëse aplikohet) [Origjinal]
6. Specifikimet e operacioneve (nëse aplikohet) [Origjinal]
7. Një kopje e lejes / miratimit / së certifikatës së dhënë operatorit nga autoriteti kompetent i shtetit të operatorit që lejon transportimin e mallrave të rrezikshme nëpërmjet ajrit (nëse është e aplikueshme) [Origjinal]

#### **2. Rekomandimet**

1. Te sqarohet kundërthënia ne mes te zgjatjes se afatit dhe emërtimit te kësaj licence ne kuptim te termit "ripërtëritje"

#### **3. Arsyetimi i rekomandimeve**

1. **Te sqarohet kundërthënia ne mes te zgjatjes se afatit dhe emërtimit te kësaj licence në kuptim të termit "ripërtëritje":** Në bazë të Rregullores së AAC NR. 04/2020 për kushtet dhe metodat e transportit të mallrave të rrezikshme përmes ajrit [neni 15.3.] “Certifikata për mallrat e rrezikshme lëshohet për një afat kohor të pacaktuar”. Kështu, është i paqartë emërtimi i kësaj licence, përfaktin se nuk është e qartë se kur shfaqet nevojë përi ripërtëritje të një licence që jepet pa afat.

## **73. PRANIMI I KOORDINATORIT PËR MALLRAT E RREZIKSHME<sup>3</sup>**

### **1. Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës**

Kjo licencë nuk parashihet me LAC. Dispozitat që kanë të bëjnë me mallrat e rrezikshme, por jo lidhur me organizatat trajnuese për mallrat e rrezikshme, janë nenet 57-59 të LAC. Dispozitat që kanë të bëjnë me këtë licencë janë pjesë e Rregullores së AAC NR. 04/2020 për kushtet dhe metodat e transportit të mallrave të rrezikshme përmes ajrit. Neni 16 i kësaj Rregullore përcakton se kush dhe si mund te behet pranimi i koordinatorit për mallrave të rrezikshme.

#### **1.1. Veprimitaria për të cilën lëshohet leja/licenca**

Veprimitaria e kësaj licence është pranimi i koordinatorit të mallrave të rrezikshme.

#### **1.2. Vlefshmëria kohore e lejes/licencës**

N/A

#### **1.3. Pagesa për pajisjen me leje/licencë**

50 euro.

#### **1.4. Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

1. CV [Origjinal]
2. Kopjen e diplomave dhe certifikatave përkatëse
3. Dokumente tjera mbështetëse
4. Pagesën e tarifës [Origjinal]

### **2. Rekomandimet**

1. Kjo licencë të përcaktohet me ligj;
2. Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio;
3. Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike;
4. Të krijohet një PVK në AAC;
5. Afati i licencës të përcaktohet me rregullore;
6. Veprimitaria e licencave të përcaktohet me akte nënligjore;
7. Të hartoher një rregullore e veçantë për procedurën dhe kriteret e lëshimit.

### **3. Arsyetimi i rekomandimeve**

1. **Kjo licencë të përcaktohet me ligj.** LSLL është ligj horizontal, në përputhje me të cilin Ligj duhet të jenë edhe ligjet e tjera. Në LAC dhe aktet përkatëse nënligjore duhet të adresohet kjo çështje dhe emërtimi të jetë në përputhje me LSLL. Po ashtu, neni 17.1 i LSLL përcakton që licencat duhet të përcaktohen vetëm me ligj. Në rastin konkret, nuk mjafton vetëm baza ligjore materiale, si obligim për operatorin, respektivisht si kompetencë e AAC, por se, me LAC, specifisht duhet të përcaktohet ky lloj i licencës. LAC nuk përbën dispozita për ndryshimin e kësaj leje dhe licence, andaj një gjë e tillë duhet të bëhet me ndryshimin e nenit 62 të LAC.

---

<sup>3</sup> Ky shërbim nuk gjendet ne Registrin Qendoror te Lejeve dhe Licencave (RQLL).

2. **Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio.** Në rastet kur nuk është e mundur që kjo licencë të ipet pa afat të caktuar, ripërtërija e kësaj licence duhet të bëhet sipas detyrës zyrtare, përmes ndonjë procedurë të verifikimin ex-officio të fakteve dhe jo përmes një procedure të re administrative për aplikim. Kjo mund të përcaktohet me akt nënligjor nga ana e AAC. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSLL.
3. **Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike.** AAC duhet të aplikojë parimin e ndihmës administrative, përgjatë zhvillimit të procedurës dhe këtë ta bëjë të kombinuar me parimin e zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare. Përmes aplikimit të këtyre parimeve, AAC do të shhang dorëzimin e këtyre dokumenteve dhe do të lehtësojnë barrën administrative për aplikim.
4. **Të krijohet një PVK në AAC.** Një sportel i vetëm apo pikë e vetme e kontaktit duhet të krijohet në AAC, për sa i takon procedurës së aplikimit dhe shqyrtimit të licencave dhe lejimeve tjera të AAC. Kjo pikë e vetme e kontaktit do të lehtësojë procedurën dhe do të koncentrojë kapacitetet shqyrtuese në këtë pikë. Po ashtu një gjë e tillë do të ndihmojë aplikuesit që në mënyrë efikase të fillojnë dhe përfundojnë procedurën si dhe gjithashtu, kjo do t'i ndihmoj edhe organin që më lehtësish të shqyrtoj aplikimin. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSLL.
5. **Afati i licencës të përcaktohet me rregullore.** Në rastin konkret, afati është marrë nga të dhënat e ofruara nga AAC. Mirëpo, në rregullativën e AAC, nuk është gjetur ndonjë dispozitë që flet lidhur me kohëzgjatjen e kësaj licence. Në përputhje me nenin 17 të LSLL dhe me qëllim të rritjes së sigurisë juridike, duhet të miratohen rregulla që përcaktojnë kohëzgjatjen e kësaj licence.
6. **Veprimitaria e licencave të përcaktohet me akte nënligjore:** Bazuar në nenin 17.2 të LSLL, rekomandohet që me rastin e nxjerrjes së rregulloreve të veçanta procedurale, për secilën leje dhe licencë të përcaktohet më saktësisht veprimitaria e tyre.
7. **Të hartoher një rregullore e veçantë për procedurën dhe kriteret e lëshimit:** Me qëllim të uniformimit të procedurave të aplikimit për këtë licencë, kriterete për këtë licencë, dokumentet e nevojshëm dhe çështjet e tjera të shqyrtimit, komfor LPPA, rekomandohet të nxjerrët një rregullore e veçantë për procedurën dhe kriteret e lëshimit. Një rregullore e tillë, në të cilën do të ndihmonte AAC për ti jetësuar parimet e LPPA dhe LSLL, në lehtësimin e procedurave për lëshimin e kësaj leje dhe licence si dhe do ti ndihmonte palët që në mënyrë efikase të informoheshin për procedurat, kriteret dhe aspektet e tjera për lëshimin në fjalë. Në rastin konkret, dokumentet e nevojshme për aplikim janë marrë nga të dhënat e ofruara nga AAC dhe të njëjtat nuk janë pjesë e Regjistrat Qendror te Lejeve dhe Licencave.

## **74. CERTIFIKIMI I OFRUESVE TË TRAJNIMIT NË FUSHËN E TRANSPORTIT TË MALLRAVE TË RREZIKSHME**

### **1. Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës**

Kjo licencë nuk parashihet me LAC. Dispozitat që kanë të bëjnë me mallrat e rrezikshme, por jo lidhur me organizatat trajnuese për mallrat e rrezikshme, janë nenet 57-59 të LAC. Dispozitat që kanë të bëjnë me këtë licencë janë pjesë e Rregullores së AAC NR. 04/2020 për kushtet dhe metodat e transportit të mallrave të rrezikshme përmes ajrit. Neni 30.1. i kësaj Rregullore përcakton se “Trajnimi për mallra të rrezikshme mund të zhvillohet nga një ofrues i shërbimit të cilit AACK-ja i ka lëshuar një certifikatë”.

### **1.1. Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca**

Qëllimi i kësaj procedure është certifikimi i ofruesve që ka për qëllim që të kryej trajnime përmallrat e rrezikshme (sipas RQLL).

### **1.2. Vlefshmëria kohore e lejes/licencës**

2 vite

### **1.3. Pagesa për pajisjen me leje/licencë**

500 euro.

### **1.4. Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

1. Formën e aplikimit për lëshimin e certifikatës për ofruesin e trajnimit [Origjinal]
2. Përshkrimin e strukturës organizative [Origjinal]
3. Listën e kualifikimeve të personelit udhëheqës dhe të instruktorëve [Origjinal]
4. Përshkrimin e klasave dhe objekteve të tjera [Origjinal]
5. Përshkrimin e programit të trajnimit, duke përfshirë manualet, kurrikulën, oraret dhe materialet mësimore [Origjinal]
6. Përshkrimin e sistemit për sigurimin e cilësisë [Origjinal]

### **2. Rekomandimet**

1. Kjo licencë të përcaktohet me ligj;
2. Të krijohet një PVK në AAC;
3. Veprimtaria e licencave të përcaktohet me akte nënligjore.

### **3. Arsyetimi i rekomandimeve**

1. **Kjo licencë të përcaktohet me ligj.** LSLL është ligj horizontal, në përputhje me të cilin Ligj duhet të jenë edhe ligjet e tjera. Ky ligj nuk i njeh “aprovimet” si lloje të lejimeve, të përcaktuara në nenin 5 të tij. Për këtë arsy, në LAC dhe aktet përkatëse nënligjore duhet të adresohet kjo çështje dhe emërtimi të jetë në përputhje me LSLL. Po ashtu, neni 17.1 i LSLL përcakton që licencat duhet të përcaktohen vetëm me ligj. Në rastin konkret, nuk mjafton vetëm baza ligjore materiale, si obligim për operatorin, respektivisht si kompetencë e AAC, por se, me LAC, specifisht duhet të përcaktohet ky lloj i licencës. LAC nuk përban dispozita për ndryshimin e kësaj leje dhe licence, andaj një gjë e tillë duhet të bëhet me ndryshimin e nenit 62 të LAC.
2. **Të krijohet një PVK në AAC.** Një sportel i vetëm apo pikë e vetme e kontaktit duhet të krijohet në AAC, për sa i takon procedurës së aplikimit dhe shqyrimit të licencave dhe lejimeve tjera të AAC. Kjo pikë e vetme e kontaktit do të lehtësojë procedurën dhe do të koncentrojë kapacitetet shqyruese në këtë pikë. Po ashtu një gjë e tillë do të ndihmojë aplikuesit që në mënyrë efikase të fillojnë dhe përfundojnë procedurën si dhe gjithashtu, kjo do t'i ndihmoj edhe organin që më lehtësish të shqyrtoj aplikimin. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSLL.
3. **Veprimtaria e licencave të përcaktohet me akte nënligjore:** Bazuar në nenin 17.2 të LSLL, rekomandohet që me rastin e nxjerjes së rregulloreve të veçanta procedurale, për secilën leje dhe licencë të përcaktohet më saktësish veprimtaria e tyre.

**75.LICENCË PËR PARAGLAJD, VAZHDIM TË LICENCËS SË PARAGLAJDIS, KONVERTIM TË LICENCËS, RIPËRTËRITJE, ETJ.**

## **1. Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës**

Kjo licencë nuk parashihet me LAC. Dispozitat që kanë të bëjnë me Licenca dhe Klasifikimi i Personelit të Avacionit, është nen 37 i LAC, i cili përcakton se “Çdo person i cili vepron si personel i aviacionit duhet të posedojë licencën dhe klasifikimin përkatës të lëshuar apo të shpallur te vlefshme nga AAC-ja sipas këtij Ligji dhe rregulloreve përkatëse të zbatimit. Klasifikimi nënkupton çdo shënim në licencë i cili i thekson kushtet, privilegjet apo kufizimet speciale. Kjo dispozitë aplikohet edhe për personelin e navigimit ajror dhe të mirëmbajtjes si dhe për zyrtarët e operimeve të fluturimit, operatorët e stacionit aeronautik dhe për instruktorët e fluturimit”. Dispozitat që kanë të bëjnë me këtë licencë janë pjesë e Rregullore (AAC) nr. 06/2020 për kushtet dhe mënyrën e përdorimit të paraglajdëve dhe deltaplanëve.

### **1.1. Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca**

Veprimtaria e kësaj licence është licencimi i personelit të fluturimit paraglajd.

### **1.2. Vlefshmëria kohore e lejes/licencës**

E përhershme

### **1.3. Pagesa për pajisjen me leje/licencë**

50 euro.

### **1.4. Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

1. Aplikacioni [Origjinal]
2. Aprovimi nga Instruktori/Examiner [Origjinal]
3. Dëshmia e kalimit të provimit teorik dhe praktik [Origjinal]
4. Dëshmia e pagesës së aplikacionit [Kopje]

### **2. Rekomandimet**

1. Kjo licencë të përcaktohet me ligj;
2. Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike;
3. Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio;
4. Të krijohet një PVK në AAC;
5. Veprimtaria e licencave të përcaktohet me akte nënligjore.
6. Të caktohet me rregullore tarifa për aplikim
7. Te sqarohet kundërthënia ne mes te zgjatjes se afatit dhe emërtimit te kësaj licence ne kuptim te termit "ripërtëritje"

### **3. Arsyetimi i rekomandimeve**

1. **Kjo licencë të përcaktohet me ligj:** LSLL është ligj horizontal, në përputhje me të cilin Ligj duhet të jenë edhe ligjet e tjera. Në LAC dhe aktet përkatëse nënligjore duhet të adresohet kjo çështje dhe emërtimi të jetë në përputhje me LSLL. Po ashtu, nen 17.1 i LSLL përcakton që licencat duhet të përcaktohen vetëm me ligj. Në rastin konkret, nuk mjafton vetëm baza ligjore materiale, si obligim për operatorin, respektivisht si kompetencë e AAC, por se, me LAC, specifisht duhet të përcaktohet ky lloj i licencës. LAC nuk përban dispozita për ndryshimin e kësaj leje dhe licence, andaj një gjë e tillë duhet të bëhet me ndryshimin e nenit 62 të LAC.
2. **Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike.** AAC duhet të aplikojë parimin e ndihmës administrative, përgjatë zhvillimit të procedurës dhe

këtë ta bëjë të kombinuar me parimin e zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare. Përmes aplikimit të këtyre parimeve, AAC do të shhang dorëzimin e këtyre dokumenteve dhe do të lehtësojnë barrën administrative për aplikim.

3. **Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio.** Në rastet kur nuk është e mundur që kjo licencë të ipet pa afat të caktuar, ripërtërija e kësaj licence duhet të bëhet sipas detyrës zyrtare, përmes ndonjë procedurë të verifikimin ex-officio të fakteve dhe jo përmes një procedure të re administrative për aplikim. Kjo mund të përcaktohet me akt nënligjor nga ana e AAC. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSLL.
4. **Të krijohet një PVK në AAC.** Një sportel i vetëm apo pikë e vetme e kontaktit duhet të krijohet në AAC, për sa i takon procedurës së aplikimit dhe shqyrtimit të licencave dhe lejimeve tjera të AAC. Kjo pikë e vetme e kontaktit do të lehtësojë procedurën dhe do të koncentrojë kapacitetet shqyruese në këtë pikë. Po ashtu një gjë e tillë do të ndihmojë aplikuesit që në mënyrë efikase të fillojnë dhe përfundojnë procedurën si dhe gjithashtu, kjo do t'i ndihmoj edhe organin që më lehtësish të shqyrtoj aplikimin. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSLL.
5. **Veprimtaria e licencave të përcaktohet me akte nënligjore:** Bazuar në nenin 17.2 të LSLL, rekomandohet që me rastin e nxjerjes së rregulloreve të veçanta procedurale, për secilën leje dhe licencë të përcaktohet më saktësish veprimtaria e tyre.
6. **Të caktohet me rregullore tarifa për aplikim.** Në rregullohet e AAC lidhur me tarifa, nuk përcaktohet tarifa lidhur me këtë licencë. Referenca për tarifë është marrë nga të dhënat e ofruara nga AAC. Me qëllim të rritjet se sigurisë juridike, me akte nënligjore të AAC duhet të përcaktohet lartësia e tarifës për këtë shërbim. LSLL në nenin 18 përcakton një taksë proporcionale, për aq sa ajo është e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin. Në përputhje me këtë parim duhet të jetë edhe niveli i taksës. Për më tepër, është e nevojshme që tarifa të jetë fikse dhe mos të përcaktohet përmes elementeve dytësore që mundësojnë caktimin e tarifës. Një qasje e tillë ka potencial të paraqesë diskriminim apo pasiguri juridike. Për këtë arsy, AAC duhet të përcaktojë tarifa fikse.
7. **Te sqarohet kundërthënia ne mes te zgjatjes se afatit dhe emërtimit të kësaj licence në kuptim të termit "ripërtëritje":** Rregullore (AAC) nr. 06/2020 për kushtet dhe mënyrën e përdorimit të paraglajdëve dhe deltaplanëve, nuk parashihet ripërtëritje per paraglajd. Kështu, është i paqartë emërtimi i kësaj licence, për faktin se nuk është e qartë se kur shfaqet nevojë përi ripërtëritje të një licence që jepet e përhershshme.

## 76. CERTIFIKIMI PËR MBAJTJE TË PROVIMIT TEORIK PËR SISTEME TË MJETEVË AJRORE PA PILOT (SAP)

### 1. Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës

Kjo licencë nuk është e përcaktuara me LAC. Dispozitat lidhur me këtë licencë janë të përcaktuara me Rregulloren (AAC) nr. 01/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 01/2017 për sistemet e mjeteve ajrore pa pilot (SAP).

#### 1.1. Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca

Veprimtaria e kësaj licence është Regjistrimi i sistemeve te mjeteve ajrore pa pilot (SAP).

#### 1.2. Vlefshmëria kohore e lejes/licencës

Pesë (5) vite.

### **1.3. Pagesa për pajisjen me leje/licencë**

10-50 euro.

### **1.4. Dokumentet e nevojshme për aplikim**

1. Formulari i plotësuar [Origjinal]
2. Përshkrimin e operimit dhe zonës të fluturimit [Origjinal]
3. Llojin e SAP që do të përdoret për operimin e fluturimit [Origjinal]
4. Fotot e SAP i cili do të përdoret [Origjinal]
5. Manualin e fluturimit ose manualin e përdoruesit [Origjinal]
6. Deklaratën e nënshkruar [Origjinal]
7. Certifikata e testit të njohurisë (për Kategoritë 3 dhe 4 të SAP) [Origjinal]
8. Pagesa e tarifës për regjistrim të SAP [Origjinal]

### **2. Rekomandimet**

1. Kjo licencë të përcaktohet me ligj;
2. Të përcaktohet procedura e ankesës për rast të mos licencimit;
3. Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio;
4. Të krijohet një PVK në AAC;
5. Të hartoher një rregullore e veçantë për procedurën dhe kriteret e lëshimit të aprovimeve.

### **3. Arsyetimi i rekomandimeve**

1. **Kjo licencë të përcaktohet me ligj.** LSLL është ligj horizontal, në përputhje me të cilin Ligj duhet të jenë edhe ligjet e tjera. Në LAC dhe aktet përkatëse nënligjore duhet të adresohet kjo çështje dhe emërtimi të jetë në përputhje me LSLL. Po ashtu, nen 17.1 i LSLL përcakton që licencat duhet të përcaktohen vetëm me ligj. Ky rekomandim mund të zbatohet përmes ndryshimit dhe plotësimit të LAC.
2. **Afat i licencës të përcaktohet me rregullore.** Në rastin konkret, afati është marrë nga të dhënat e ofruara nga AAC. Mirëpo, në rregullativët e AAC, nuk është gjetur ndonjë dispozitë që flet lidhur me kohëzgjatjen e kësaj licence. Në përputhje me nenin 17 të LSLL dhe me qëllim të rritjes së sigurisë juridike, duhet të miratohen rregulla që përcaktojnë kohëzgjatjen e kësaj licence.
3. **Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio.** Në rastet kur nuk është e mundur që kjo licencë të ipet pa afat të caktuar, ripërtërija e kësaj licence duhet të bëhet sipas detyrës zyrtare, përmes ndonjë procedurë të verifikimin ex-officio të faktave dhe jo përmes një procedure të re administrative për aplikim. Kjo mund të përcaktohet me akt nënligjor nga ana e AAC. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton nen 17.2 i LSLL.
4. **Të krijohet një PVK në AAC.** Një sportel i vetëm apo pikë e vetme e kontaktit duhet të krijohet në AAC, përsa i takon procedurës së aplikimit dhe shqyrtimit të licencave dhe lejimeve tjera të AAC. Kjo pikë e vetme e kontaktit do të lehtësojë procedurën dhe do të koncentrojë kapacitetet shqyrtuese në këtë pikë. Po ashtu një gjë e tillë do të ndihmojë aplikuesit që në mënyrë efikase të fillojnë dhe përfundojnë procedurën si dhe gjithashtu, kjo do t'i ndihmoj edhe organin që më lehtësish të shqyrtoj aplikimin. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton nen 17.2 i LSLL.
5. **Të hartoher një rregullore e veçantë për procedurën dhe kriteret e lëshimit.** Me qëllim të uniforimit të procedurave të aplikimit për këtë licencë, kriterete për këtë licencë, dokumentet e nevojshëm dhe çështjet e tjera të shqyrtimit, konform LPPA, rekomandohet të nxjerrët një rregullore e veçantë për procedurën dhe kriteret e lëshimit. Një rregullore e tillë, në të cilën do të

ndihmonte AAC për ti jetësuar parimet e LPPA dhe LSLL, në lehtësimin e procedurave për lëshimin e kësaj leje dhe licence si dhe do ti ndihmonte palët që në mënyrë efikase të informoheshin për procedurat, kriteret dhe aspektet e tjera për lëshimin në fjalë.

## 77. VENDIMI PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT NXITËS

### 1. Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës

Kjo licencë nuk parashihet me ligj. Dispozita lidhur me këtë çështje janë të përfshira në Rregulloren Nr.3/2015 mbi tarifat e aeroportit, përkatësisht Neni 8 Modulimi i tarifave të aeroportit. Licenca nuk është e përcaktuar me ligj, siç përcakton neni 17.1 i LSLL.

#### 1.1. Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca

Veprimtaria e kësaj licencë është programi i skemës nxitëse, pasi qe te jete aplikuar modulimi i tarifave të aeroportit.

#### 1.2. Vlefshmëria kohore e lejes/licencës:

Varësisht sa është validiteti i programit nxitës

#### 1.3. Pagesa për pajisjen me leje/licencë:

N/A

#### 1.4. Dokumentet e nevojshme për aplikim:

1. Objektivi i shpenzimeve operuese;
2. Parashikimet e të hyrave operuese;
3. Prosesverbali i mbledhjes së komitetit konsultativ;
4. Marrëveshja mbi nivelin e shërbimit, nëse aplikohet;
5. Plani investues dhe financimi i tij.

### 2. Rekomandimet

1. Kjo licencë të përcaktohet me ligj;
2. Të caktohet me rregullore tarifa për aplikim;
3. Të krijohet një PVK në AAC;

### 3. Arsyetimi i rekomandimeve

1. **Kjo licencë të përcaktohet me ligj.** LSLL është igj horizontal, në përputhje me të cilin Ligj duhet të jenë edhe ligjet e tjera. Në LAC dhe aktet përkatëse nënligjore duhet të adresohet kjo çështje dhe emërtimi të jetë në përputhje me LSLL. Po ashtu, neni 17.1 i LSLL përcakton që licencat duhet të përcaktohen vetëm me ligj.
2. **Të caktohet me rregullore tarifa për aplikim.** Në rregullohet e AAC lidhur me tarifa, nuk përcaktohet tarifa lidhur me këtë licencë. Referanca për tarifë është marrë nga të dhënat e ofruara nga AAC. Me qëllim të rritjet se sigurisë juridike, me akte nënligjore të AAC duhet të përcaktohet lartësia e tarifës për këtë shërbim. LSLL në nenin 18 përcakton një taksë proporcionale, për aq sa ajo është e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin. Në përputhje me këtë parim duhet të jetë edhe niveli i taksës. Për më tepër, është e nevojshme që tarifa të jetë fiksë dhe mos të përcaktohet përmes

elementeve dytësore që mundësojnë caktimin e tarifës. Një qasje e tillë ka potencial të paraqesë diskriminim apo pasiguri juridike. Për këtë arsyе, AAC duhet të përcaktojë tarifa fikse.

3. **Të krijohet një PVK në AAC:** Një sportel i vetëm apo pikë e vetme e kontaktit duhet të krijohet në AAC, përsa i takon procedurës së aplikimit dhe shqyrtimit të licencave dhe lejimeve tjera të AAC. Kjo pikë e vetme e kontaktit do të lehtësojë procedurën dhe do të koncentrojë kapacitetet shqyruese në këtë pikë. Po ashtu një gjë e tillë do të ndihmojë aplikuesit që në mënyrë efikase të fillojnë dhe përfundojnë procedurën si dhe gjithashtu, kjo do t'i ndihmoj edhe organin që më lehtësisht të shqyrtoj aplikimin. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSLL.